



Raport HOTSPOTET MJEDISORE NË KOSOVË



**MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
AGJENCIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS**

Raport
HOTSPOTET MJEDISORE
NË KOSOVË

Prishtinë, 2011

Ky Raport është përgatitur nga
Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

Raportin e përgatiten:

Msc. Tafe Veselaj, AMMK

Msc. Afrim Berisha, AMMK

Msc. Mimoza Hyseni-Spahiu, AMMK

Msc. Perparim Gashi, AMMK

Sylejman Bejta, MZHE

Tabela e shkurtesave

Shkurtesa	Emri i plotë
AER	Agjensioni Evropian i Rindertimit
AKP	Agjencioni i Kosovës për Privatizim
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
BAT	Teknologjia më e mirë e aplikueshme
BE	Bashkimi Evropian
BVP	Bruto Vjetore e Prodhimit
DANIDA	Agjencioni Ndërkombëtar Danez për Zhvillim
DUTCH	Agjencioni Hollandeze për Zhvillim
EMKO	Mbetje nga procesi i përpunimit të Zinkut
ESK	Enti i Statistikave të Kosovës
EAP 6	Programi i 6-të i Veprimit në Mjedis i BE-së
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
IFCS	Programi Ndërkombëtarë për Siguri të Kemikateve
REACH	Rregullore për Regjistrim, Vlerësim, Autorizim dhe Kufizim të Kemikateve
IPPC	Direktiva per Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar te ndotjës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOR	Forcat Paqëruajtëse në Kosovë
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Mjedisor
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësis
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PIM	Parku Industrial i Mitrovicës
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
SharrCem	Fabrika e Çimentos në Han të Elezit
TEC A	Termocentrali Kosova A
TEC B	Termocentrali Kosova B
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSMS	Vlerësimi Strategjik Mjedisor dhe Social

Contents

LISTA E HARTAVE	9
1. HYRJE.....	11
1.2 Falënderim.....	12
1.3 Qëllimi i Raportit.....	13
2. Profili i Kosovës.....	15
2.1 Pozita Gjeografike.....	15
2.2 Relievi.....	15
2.3 Klima	15
2.4 Ndertimi Gjeologjik	16
2.5 Popullsia	18
3. Zhvillimi ekonomik	19
3.1 Historiku i shkurtër i zhvillimit ekonomik te Kosoves.....	19
3.2 Gjendja aktuale ekonomike në Kosovë	20
3.3 Sfidat e zhvillimit ekonomik në Kosovë.....	20
4. Definimi dhe Klasifikimi i Hotspotëve	22
4.1 Kuptimi i Definicionit “Hotspot”	22
4.2 Klasifikimi i Hotspotëve	23
5. Trajtimi i hotspotëve në Kosovë.....	24
5.1 Legjislacioni nacional për trajtimin e hotspotëve	24
5.2 Koniza strategjike dhe progamore	24
5.3 Projektet e realizuara për rehabilitimin e hotspotëve	25
6. Gjendja e Hotspotëve në Kosovë.....	27
6.1 Hotspotet e identifikuar	27
6.2 Hotspotet nga kemikatet	28
6.3 Hotspotet nga aktivitetet bujqësore (pesticidet dhe fertilizerët)	29
6.3.1 Depoja e mbetjeve bujqësore në Shirok të Therandës.....	29
6.3.2 Depoja e kemikateve industriale në Pejë.....	31
6.4 Ndikimi në mjedis nga sektori i transportit	34
6.5 Hotspotet nga Deponitë sanitare	35
6.5.1 Deponia sanitare në Podujevë	35
6.5.2 Deponia sanitare në Pejë.....	36
6.5.3 Deponia sanitare në Gjilan	38
6.5.4 Deponia në Prizren	42
6.5.5 Deponia sanitare në Mirash	44
6.5.6 Deponia sanitare në Mitrovicë.....	46
6.6 Hotspotet nga aktivitetet minerare dhe industriale	48
6.6.1 Hotspotet nga sektori i industrisë	48
6.6.1.1 Parku ndustrial në Mitrovicë.....	52
6.6.1.2 Deponia e skories së Feronikelit në Çikatovë-Glllogvc	54

6.6.2	Hotspotet nga sektori mineralar.....	56
6.6.2.1	Deponitë në Hajvali, Badovc dhe Kishnicë	56
6.6.2.2	Miniera e Artanës	61
6.6.2.3	Miniera e Stan Tërgut.....	65
6.6.2.4	Deponia në Kelmend	66
6.6.2.5	Materiet radioaktive te Tuneli i parë- Mitrovicë.....	69
6.6.2.6	Materiet radioaktive në Parkun Industrial në Trepçë, Mitrovicë .	70
6.6.2.7	Deponitë në Zveçan	71
6.6.2.8	Deponitë në Leposaviq	72
6.6.2.9	Deponitë e hirit në KEK	77
6.6.2.10	Deponitë e flotacionit në Devë të Gjakovës	81
6.6.2.11	Miniera e Goleshit në Magurë- Lipjan	83
6.6.2.12	Deponia me materie të asbestit në Han të Elezit	85
7.	Të dhëna të përmbledhura për hotspotet.....	88
8.	Efektet e hotspotëve në shëndet dhe mjedis	91
9.	Konkluzionet dhe rekomandimet	94
10.	Referencat	97

LISTA E HARTAVE

1. Harta gjeologjike e Kosovës
2. Harta- Devoja e mbetjeve bujqësore në Shirokë të Suharekës
3. Harta-Devoja me kemikate industriale në Pejë
4. Harta-Deponia sanitare e mbeturinave në Podujevë
5. Harta - Deponia sanitare e mbeturina në Pejë
6. Harta - Deponia sanitare e mbeturinave në Gjilan
7. Harta - Deponia sanitare e mbeturinave në Prizren
8. Harta - Deponia sanitare e mbeturinave në Mirash-Obiliq
9. Harta - Fabrika e Ballkanit të Suharekës
10. Harta - Parku Industrial i Trepçës në Mitrovicë
11. Harta -Deponia e skories industriale të Feronikelit në Gllgovc
12. Harta - Deponit e minierës së Kishnicës në Badovc
13. Harta -Deponia e minierës në Kishnicë
14. Harta- Deponitë e minieres në Artanë
15. Harta - Topografia e deponisë së Kelmendit në Mitrovicë
16. Harta - Deponia e flotacionit në Leposaviq
17. Harta - Materiet radioaktive te Tuneli i parë, Laboratori në PIT dhe Deponia sanitare në Germovë-Mitrovicë
18. Harta - Deponitë minerale në Zveqan dhe Kelmend
19. Harta - Deponia e TEC- B, rezervaret me fenole dhe deponia e TEC- A
20. Harta - Deponia e flotacionit në Devë të Gjakovës
21. Harta- Industria e minierës së Goleshit në Magure të Lipjanit
22. Harta - Deponitë me mbetje të Asbestit në Han të Elezit
23. Harta - Harta e hotspoteve potenciale në Kosovë

LISTA E TABELAVE

- Tabela 1 : Numri i popullsisë në Kosovë 1948-2011
- Tabela 2 : Projektet për rehabilitimin e deponive të vjetra të mbeturinave komunale 2007-2009
- Tabela 3: Disa projektet të realizuara nga donacionet ndërkombëtare për rehabilitimin e mjedisit
- Tabela 4: Hotspotet nga kemikatet e rrezikshme në Suharekë dhe Pejë
- Tabela 5: Deponitë sanitare si burime potenciale të ndotjes në Kosovë
- Tabela 6: Fabrika për prodhimin e gomave dhe shiritave, Ballkani i Suharekës
- Tabela 7: Deponia industriale me mbetjet e skories në Çikatovë të Re, Gillogovc
- Tabela 8: Deponitë me metale të rënda të minierës së Kishnicës, Graçanicë
- Tabela 9: Deponitë e minierës në Artanë
- Tabela 10: Përbërja kimike e deponive me metale të rënda në pjesën veriore të Kosovës
- Tabela 11: Deponitë industriale me metale të rënda dhe materiet radioaktive të deponuara në Mitrovicë
- Tabela 12: Përmbajtja e hirit të deponive të KEK-ut sipas komponentëve përbërëse
- Tabela 13: Deponitë e hirit nga procesi industrial energjetik i KEK-ut
- Tabela 14: Deponitë e hirit dhe rezervuarët me fenole në KEK
- Tabela 15: Deponia e flotacionit të minierës në Devë, Gjakovë
- Tabela 16: Mbetjet nga miniera e Goleshit në Magure, Lipjane
- Tabela 17: Hotspotet mjedisore sipas lokacioneve, aktivitetit, sipërfaqes dhe burimeve potenciale të ndotjes
- Tabela 18: Tabela e përgjithshme e hotspoteve me aktivitetet, sipërfaqen dhe përqindje

1. HYRJE

1.1 Parathënie

Njëra ndër çështjet me ndikim në mjedisin e Kosovës janë pikat me të ndjeshme mjedisore që i quajmë edhe “pika të nxehta”, e të cilat në terminologjinë shkencore definoohen edhe si hot-spotet mjedisore. Nisur nga ky fakt MMPH bashkëpunim edhe me Ministrinë dhe institucione tjera, kanë identifikuar këtë problematikë dhe e kanë trajtuar si çështje me prioritet të lartë edhe përmes planeve dhe projekteve të caktuara.

Hot-spotet mjedisore janë krijuar kryesisht si rezultat i veprimtarisë industriale të së kaluarës, të shkaktuara nga aktivitetet e minierave, nga deponitë e vjetra të pa menaxhuara, nga kimikate të deponuara, vajra mbeturinë, pesticide të skaduara e kështu më radhë. Duke e ditur ndikimin e theksuar të këtyre hot spoteve në mjedis, si dhe rrezikun për shëndetin e qytetarëve, MMPH-ja përmes Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit ka evidencuar rreth 110 vende si pika me të ndjeshme, 26 prej të cilave janë identifikuar si hot-spotet potenciale dhe janë prezantuar në këtë publikim. Si të tilla janë ato në Komunën e Mitrovicës, - PIM, në Komunën e Obiliqit - aktivitetet e KEK-ut, në komunën e Glogocit - aktivitetet e Feronikelit, pastaj hot-spotet në Kishnicë, Artanë, Han të Elezit etj.

Duke marrë parasysh mundësitë e kufizuara financiare të Kosovës, dhe buxhetin e pamjaftueshëm të MMPH-së, nuk ka qene e mundur që kryhen të gjitha aktivitetet e nevojshme për zgjidhjen e problemeve dhe rehabilitimin e hot-spoteve. Me ndihmen dhe mbështetjen nga e Institucionet Ndërkombëtare të cilat janë duke dhënë kontribut të çmuar si: Komisioni Evropian, Qeveria Holandeze, Qeveria Çeke, Qeveria Daneze, Banka Botërore dhe UNDP, janë ndermarr aktivitete për rehabilitimi e disa hotdpoteve sikur janë deponitë e vjetra si dhe disa deponi industriale. Përkundër kësaj, Kosova ka nevojë për përcaktimin e mekanizmave efikas për menaxhimin e mjedisit përfshirë këtu edhe hot-spotet.

Për më tepër duhen bere studime më të thella për hotspotet dhe vlerësimin e kostos financiare për rehabilitimin e tyre. Gjithashtu, duhet të punohet në ndërtimin e politikave të favorshme për inkurajimin e sektorit privat dhe ndërtimin e marrëdhënieve të partneritetit në menaxhimin e mjedisit. Hot-spotet paraqesin problem serioz për mjedisin. Këto probleme kërkojnë shqyrtime, zbatim të masave përmirësuese dhe monitorim afatgjatë, me qëllim që të evitohen rreziqet e mëtejshme për natyrën dhe shëndetin e njeriut.

1.2 Falënderim

I dashur lexues,



Opinion i gjerë në Kosovë ka njohuri të pakta për ekzistimin e hospoteve mjedisore dhe aq me pak për efektet e tyre në shëndetin publik dhe mjedisin që na rrethon.

Raporti që ju tashmë keni në duar përmban informata për zonat me ndotje të lartë në Kosovë që në terminologjinë mjedisore njihen si hot-spotet. Hot spotet konsiderohen si zona të ndishme jo vetëm për mjedisin proedhe për shëndetin publik. Andaj, ato kërkojnë trajtim emergjent dhe kujdes të vazhdueshëm. Është shumë e qartë

se për zgjidhjen e problemve që krijohen nga hot-spotet nuk mund të gjindet përgjigjëja vetëm përmes hartimit të këtij raporti. Ndaj ne shpresojmë që ky raport të shërbej si një bazë e mirë për diskutimin dhe shtjellimin e mëtejshëm të rrugëve që çojnë në zbutjen e problemeve të këtyre zonave të ndjeshme.

Raporti është përgatitur nga Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit në bashkëpunim me sektorët tjerë të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si dhe me përkrahjen e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe nga Institucionet tjera qeveritare dhe jo qeveritare.

AMMK shpreh falënderim për të gjithë ata që kontribuuan në përgatitjen e këtij Raporti. Ne shpresojmë që ky bashkëpunim është një tregues i mirë që shpreh përkushtimin e institucioneve, donatorët, ekspertëve dhe aktorëve tjerë për të bërë më shumë për identifikimin, studimin, rehabilitimin dhe eliminimin e hotspoteve mjediore në Kosovë.

Dr.Sc. Ilir Morina, Kryeshef ekzekutiv i AMMK-se

1.3 Qëllimi i Raportit

Ndotja e mjedisit është një problem i përmasave të gjera i cili nuk njihet kufinjë nacional. Ndotja e ujit, tokës dhe ajrit në shume vende të botës por edhe në Kosovë një problem serioz për mjedisin dhe një rrezik permanent për shëndetin e publik. Zhvillimi industrial që nuk respekton standardet mjedisore në të shumtën e rasteve është burimi kryesor i ndotjes. Kosova për shkak të resurseve të mëdha natyrore nëntokësore një pjesë të zhvillimit të saj ekonomik e ka pasur të orientuar në zhvillimin e sektorit minierar. Eksploatimi më i madh i këtyre resurseve ka ndodhur sidomos gjatë viteve 70 dhe 80. Si pasojë e kësaj, janë trashëguar shumë probleme edhe në fushën e mjedisit. Këtu para së gjithash duhet veçuar ndikimin në mjedis nga mbetjet e industriale, impiantet industriale, deponitë e minierave, deponitë e kemikateve nga sektori i bujqësisë etj.

AMMK, në kuadër të detyrav dhe përgjegjësisve që ka si institucion dhe në kuadër të aktiviteteve të saj në Planin e Punës ka bërë identifikimin e disa prej këtyre zonave. Identifikimi i hot-spotëve potenciale është realizuar nga AMMK ka gjetur mbështetje edhe nga UNDP përmes angazhimit të një eksperti ndërkombëtarë. Gjatë këtij hulumtimi janë identifikuar shumë loka-cione të ndjeshme mjedisore, mirëpo janë evidentuar vetën ato zona të cilat kanë ndikim më të madh në mjedis dhe që paraqesin rrezik për shëndetin publik. Në tërë territorin e Kosovës janë identifikuar rreth 110 vende si pika të ndjeshme mjedisore, ndërsa si zona me potencial për ndikim më të madh në mjedis dhe që paraqesin rrezik për shëndetin publik janë evidentuar 28 sosh dhe të cilat janë të prezantuara në këtë Raport. Sipërfaqja e tërësishme e këtyre hotspotëve është rreth 9.94 km² ose 0.09% e territorit të Kosovës. Hotspotet e evidentuar për shkak të përmbajtjes së tyre të kontaminuar, e bëjnë të pamundur shfrytëzimin e tyre për nevoja ekonomike, bujqësore, urbanizëm, rekreacion dhe turizëm, prandaj përveç ndikimit në mjedis dhe në shëndetin publik ato kanë ndikim indirekt edhe në sfera tjera të zhvillimit shoqëror.

Qëllimi i këtij Raporti është të identifikojë hot-spotet potenciale mjedisore në Kosovë, të ofrojë informata themelore për gjendjen e tyre si dhe të inicojë projekte për hartimin e studimeve më detale për trajtimin e këtyre zonave në të ardhmen. Të dhënat për përgatitjen e raportit janë grumbulluar

nga vizitat në terren, takimeve dhe kontakteve me institucionet e ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, nga projektet e realizuara në këtë fushë si dhe nga ndërmarrjet publike që menaxhojnë me këto zona. Raporti përveç që jep nje pasqyrë reale për gjendjen e këtyre zonave, synon edhe identifikimin e nevojave më të ngutshme, më qëllim që të caktohen prioritetet për gjetjen e fondeve për rehabilitimit të tyre, duke ofruar rekomandime për zgjidhejn e këtij problemi.

2. Profili i Kosovës

2.1 Pozita Gjeografike

Kosova gjendet në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik. Shtrihet në mes të 41°50'58" dhe 43°51'42" të gjerësisë gjeografike veriore dhe 20°01'30" dhe 21°48'02" të gjatësisë gjeografike lindore. Kosova ka sipërfaqe 10.887 km², 1.73 milion banorë dhe dendësi mesatare prej 159 banor në km² (ne regjistrim nuk janë përfshirë komunat Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan). Kufizohet me Shqipërinë (në jugperëndim), me Maqedoninë (në juglindje), me Serbinë (në lindje, veri dhe verilindje) dhe me Malin e Zi (në perëndim). Gjatësia e përgjithshme e kufirit të Kosovës me vendet fqinje është rreth 700.7 km.

2.2 Relievi

Kosova është vend malor dhe me ultësira, i përbërë nga Fusha e Kosovës (me lartësi mbidetare 510-570 m) dhe Rrafshi i Dukagjinit (lartësia mbidetare 350-450 m). Lartësia mesatare mbidetare e Kosovës është 810m. Pika më e ulët është 270m, ndërsa më e larta 2656m (Gjeravica). Në aspektin hipsometrik sipërfaqe nën 300m lartësi mbidetare përfshinë vetëm 16.4 km² (0.2 %) deri 1000 m shtrihen 8754 km² (80.7 %), prej 1000 deri 2000 m 1872.3 km² (17 %) dhe mbi 2000m deri 250.6 km² (2.3 %). Format kryesore në relievin e Kosovës janë: malet me 63 % dhe fushëgropat 37%.

2.3 Klima

Klima është e mesme-kontinentale, me ndikim mbizotërues të klimës adriatiko-mesdhetare në Rrafshin e Dukagjinit, përmes luginës së Drinit të Bardhë, si dhe me ndikim më të vogël të klimës së ndryshuar adriatiko-egjeniane në fushën e Kosovës. Të reshurat mesatare vjetore **596 mm**. Temperaturat mesatare vjetore të Kosovës janë **10°C**, me temperaturën e arritur

minimale **-27,2** dhe maksimale **39,2** (IHMK, 2008). Faktorët lokal kryesorë që ndikojnë në klimën e Kosovës janë: relievi, ujërat, trualli dhe bimësia.

2.4 Ndertimi Gjeologjik

Territori i Kosovës karakterizohet me një ndërtim të ndërlikuar dhe shumë interesant gjeologjik. Këtë e dëshmojnë numri i madh i komplekseve litologjike dhe formacioneve gjeologjike nga kembriani gjerë në kuaternar.

Formimet Proterozoike shkëmbinjtë më të vjetër të Kosovës janë rreshtet kristalore të masës Dardane, që shtrihen në lindje të Kamenicës dhe Karaçevës. Ky kompleks i takon moshës së Rifej-Kembrianit, i ndërtuar prej gnajseve dhe leptinoliteve, mikashisteve, leukognajseve, amfiboliteve, kuarciteve dhe migmatiteve.

Formimet Paleozoike janë mjaft të përhapura në Kosovë dhe të zbuluara në Bjeshkët e Sharrit, Bjeshkët e Nemuna, Malet e Mognës dhe në rrethinën e Trepçës.

Formimet Mesozoike kanë përhapje të konsiderueshme në territorin e Kosovës, ku Kretaku dhe Triasiku janë më të përhapur në raport me Jurasi-kun. Formimet e Terciarit-mbushin ultësirat tektonike të Dukagjinit, Rrafshit e Kosovës, Drenicës, Llapit dhe Gjilanit, ku me hulumtime paleontologjike janë konstatuar Oligoceni, Mioceni, dhe Plioceni. Produktet vullkanogjene ndërtojnë rajonin e Stantergut, Kishnicë-Janjevës, Moravës së Binçës dhe Strezovc-Artanës.

Depozitimet Kuaternare - mbulojnë fushat e rrafshëta dhe shtretërit e lumenjve të Drinit të Bardhë, Sitnicës dhe Moravës së Binçës, të përfaqësuara me sedimentet e teracave lumore, produkteve aluviale, proluviale, deluviale dhe morenave.

2.5 Popullsia

Popullsia e Kosovës në periudhën 1948-1981 duke iu referuar regjistrimeve zyrtare të popullsisë ka pasur rritje të vazhdueshme, ku nga 727,820 banorë ka shtuar popullsin e saj në 1,584,440, që tregon rritje prej 856,620 banorë ose 117.9%. Pas kësaj periudhe, Kosova për një kohë të gjatë (30 vjeçare) ka pasur mungesë të të dhënave statistikore zyrtare për popullsinë, kështu që përcaktimi i numrit të popullsisë bazohet kryesisht në vlerësime dhe parashikime.

Një vlerësim i tillë është bërë edhe në vitin 1991, sipas të cilit Kosova kishte 1,956,196 banorë. Në vitin 2011, Enti i Statistikave të Kosovës, ka bërë regjistrimin e popullsisë i cili nuk ishte gjithëpërfshirës. Rezultatet preliminare të këtij regjistrimi tregojnë që Kosova ka 1,733,872 banorë. Numri i popullsisë së Kosovës sipas këtij regjistrimi nuk është në përputhje me trendin e rritjes së popullsisë në Kosovë. Kjo mund të jetë pasojë e disa faktorëve si: ndryshimi i metodologjisë së regjistrimit, shpërngulja e popullsisë gjatë viteve 90 ku llogaritet të kenë braktisur Kosovën rreth 400 mijë banorë, mospërfshirja e gjithë popullatës në regjistrim dhe faktorë të tjerë.

Popullsia e Kosovës është me moshë të re. Në vitin 2006 grup-mosha 0-19 vjeç përbën 38 %, grup-mosha e 20-64 përbën 56 % kurse grup-mosha e vjetër mbi 65 vjeç përbën 6 % të popullsisë së përgjithshme.

Table 1 : Numri i popullsisë në Kosovë 1948-2011

No	Viti	Nr. i popullsisë	Burimi i të dhënave
1	1948	727,820	Regjistrim, ESK
2	1961	963,988	Regjistrim, ESK
3	1971	1,243,693	Regjistrim, ESK
4	1981	1,584,440	Regjistrim, ESK
5	1991	1,956,196	Vlerësim, ESK
6	2011	1,733,872	Rezultate preliminare të Regjistrimit, ESK

3. Zhvillimi ekonomik

3.1 Historiku i shkurtër i zhvillimit ekonomik te Kosoves

Duke shikuar nga kronologjia e zhvillimit ekonomik të Kosovës, vërehet se deri në 1950, Kosova ishte vend tipik agrar, pa industri të zhvilluar, ku bujqësia merrë pjesë me 70 % në BPV. Vitet 1947 – 70, njihet si periudhë e cila Kosovën e karakterizon me përjashtim të investimeve nga fondet shtetërore pa kthim.

Në periudhën në mes viteve 1971-1980, Kosova arrin shkallën më të lartë të rritjes ekonomike dhe të ndryshimeve cilësore në strukturën e prodhimit. Në këtë Interval kohor janë realizuan projektet më të rëndësishme në industri, infrastrukturë dhe ekonomi.

Gjatë viteve 1989-1998, njihet si periudha e paralizimit të zhvillimit ekonomik në të gjitha degët e ekonomisë. Në këtë kohë Kosova karakterizohet me tensione politike të karakterit të mbyllur deri në vitin 1999 kur konflikti merr përmasa e luftës frontale e cila ndikoj edhe me ndërhyrjen e faktorit ndërkombëtar. Me vendosjen e misionit të OKB në Kosovë, u ndërморën masa për tejkalimin e situatës së vështirë ekonomike dhe sociale. Gjatë viteve 1999-2010, pjesën më të madhe të ndihmës ekonomike e kanë realizuar donatorët e jashtëm.

Ekonomia e Kosoves ende pret të rimëkëmbet përmes procesit të privatizimit i cili është ne proces. Biznesi privat ka shënuar hapa të dukshëm të zhvillimit (51% të BPV). Gjithashtu diaspora përben një faktorë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik, e cila është treguar e gatshme të investojë, mirëpo ende nuk ka infrastrukturë ligjore të përshtatshme për investime kapitale nga jashtë².

2 Raport i Këshillit Amerikan për Zhvillim Ekonomik

3.2 Gjendja aktuale ekonomike në Kosovë

Numri total i ndërmarrjeve deri në fund të vitit 2009 ka arritur shifrën prej 74436 ndërmarrje. Krahasuar me vitin 2008 (67950 ndërmarrje) vërehet një rritje e numrit të ndërmarrjeve të reja për 6486 ndërmarrje apo e shprehur në përqindje 9.5%.

Nga numri total i ndërmarrjeve vërehet se aktivitet ekonomike më të preferuara janë: tregtia me 33826 ndërmarrje (45,4%), transporti dhe telekomunikacioni me 9641 (12.95%), hotelet dhe restorantet me 7230 (9.7%), industria përpunuese 6976 (9.4%), ndërtimtaria me 4418 (5.9%), aktivitetet tjera shoqërore (sociale) dhe personale 4121 (5.5%), pasuria e patundshme dhe dhënia me qira me 3788 (5.1%) dhe aktivitetet tjera përfshijnë pjesën e mbetur në shkallë më të vogël³.

Një shtytje për zhvillimin ekonomik të Kosovës mund të konsiderohet edhe procesi i privatizimit të ndërmarrjeve publike. Agjencioni për Privatizim i Kosovës (APK) është institucioni që ka përgjegjësinë për procesin e privatizimit të ndërmarrjeve publike. Si raste të suksesshme në procesin e privatizimit me ndikim në zhvillimin ekonomik të Kosovës mund të përmendën: Fabrika e Ferronikelit, Banja në Kllokot, Vreshtaria Stone Castle, Hotel Theranda, Trofta, M [HYPERLINK "http://www.pak-ks.org/data/M%20&%20Sillosi_FLV\(2\).flv"](http://www.pak-ks.org/data/M%20&%20Sillosi_FLV(2).flv) & [HYPERLINK "http://www.pak-ks.org/data/M%20&%20Sillosi_FLV\(2\).flv"](http://www.pak-ks.org/data/M%20&%20Sillosi_FLV(2).flv) Silosi, Birraria e Pejës, Hotel Nora etj.

3.3 Sfidat e zhvillimit ekonomik në Kosovë

Kosova në kontekstin rajonal dhe atë evropian, sipas BPV-së ka një nivel shumë të ulët të zhvillimit ekonomik dhe zë vendin e fundit në listë. Zhvillimi i pabarabartë ekonomik ose shpërpjesëtimet më të theksuara, origjinën e kanë në nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik të trashëguar, pasojat e situatës ekonomiko politike gjatë viteve të nëntëdhjeta, në resurset dhe fondet e kufizuara zhvillimore dhe në proceset e ndërlikuara tranzitore në kushte të rindërtimit të pasluftës.

Shpërpjesëtimet më të shprehura kanë të bëjnë me: raportin midis BPV dhe konsumit, eksportit dhe importit, ofertës dhe kërkesës për fuqi punëto-re, buxhetit të konsoliduar dhe nevojave për investime në infrastrukturë dhe shërbime publike. Rritja e qëndrueshmërisë ekonomike, si një çështje

3 Raporti statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike në Kosovë T4 – 2009, faqe 9

me rëndësi parësore, sfidohet me shpërpjesëtimet prezent që e karakterizojnë në këtë moment ekonominë e Kosovës.

Zhvillimi i industrializimit në bazë të burimeve natyrore në të kaluarën është shprehur në shtrirjen jo proporcionale të efekteve të këtij zhvillimi. Kështu gjatë viteve shtatëdhjeta deri në gjysmën e dytë të viteve tetëdhjeta në aspektin e zhvillimit industrial dhe urban qartas janë diferencuar shtatë qendrat më të mëdha urbane.

Me rrënimin e strukturës së vjetër industriale, deindustrializimin e viteve 90-ta dhe ndryshimet e mëdha teknologjike që ndodhën viteve të fundit ndikuan që këto zona të mos kenë ndonjë ndikim të rëndësishëm në procesin e zhvillimit të ri ekonomik.

Pasojat e zhvillimit të pabarabartë reflektohen në aspekte të ndryshme si atë social, ekonomik dhe mjedisor.

Zhvillimi i pabarabartë në aspektin mjedisor ka për pasojë shfrytëzimin joracional të tokës, dukuri kjo e mbështetur në jo efikasitetet në sferën e planifikimit, monitorimit dhe zhvillimit të qendrueshem.

4. Definimi dhe Klasifikimi i Hotspoteve

4.1 Kuptimi i Definicionit “Hotspot”

Termi “hotspot” tani më është bërë një definicion i rëndomtë në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Ai gjithnjë e më shumë është duke u përdorur për të tërhequr vëmendjen në situata specifike të veçanta apo shqetësime mjedisore. «Hot-spot» në fakt është një nocion i ri, i veçant dhe më disa kuptime. Kuptimi i tij i varet nga konteksti në të cilin ai përdoret. Ne përgjithësi ai përdoret për të treguar një aktivitet, në një vend apo në një situatë që është përtej të zakonshme, qoftë në aspektin pozitivë (psh. zona me biodiversitet të pasur etj), apo edhe në atë negative (zona me ndotje të lartë të mjedisit)

Padryshim se interes të veçantë për lexuesit dhe ambientalistet ka përdorimi i termit “hotspot” për të përshkruar zonat me potencial të lartë të ndotjes për shkak të ndikimit të tyre në mjedis dhe në shëndetin publik. Zakonisht ambientalistët e përdorin termin “hot-spot” kur i referohen ndryshimeve negative dhe përkeqësimeve mjedisore në një zonë të caktuar, apo për të përshkruar zonat e kontaminuara që nuk kanë pasur mbikëqyrje dhe përkujdesje për një periudhë të shkurt apo më të gjatë kohore dhe që kanë efekte të dëmshme për mjedisin dhe për botën e gjallë. Pra kuptimin negativ i termit “hotspot” është diçka i padëshiruar, jo i favorshëm, dhe i rrezikshëm për mjedisin dhe shëndetin.

Në kuadër të nocioneve dhe terminologjive që përdoren në legjislacionin mjedisor të Kosovës nuk ka ndonjë definim adekuat për termin “hotspote”, edhe pse shpesh në kuadër të shtjellimit të problematikave të caktuar përdoret ky definim.

Në këtë raport termin “hotspot” duhet ta kuptoni në kuptimin negativ pasi që në raport janë trajtuar zonat e ndotura të cilat janë krijuar si rezultat i veprimtarive të ndryshme ekonomike.

4.2 Klasifikimi i Hotspoteve

Nuk ekziston ndonje klasifikim i veçant për hotspote, sipas ndonjë kriteri apo një kornize ligjore të caktuar. Mirëpo, nëse shikohet mënyra e krijimit të tyre ato mundë të klasifikohen sipas aktiviteteve të ndryshme ekonomike nga të cilat janë krijuar.

Këshut, nëse i referohemi Ligji për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes (Ligji Nr. 03/L-043), në anekset shtesë të tij parashihen kategoritë e ndryshme të aktiviteteve ekonomike, si rrjedhojë të cilave mund të krijohen vendet (zonat) me potencial të lartë të ndotjes (hotspote) si:

- Vende të ndotura nga industrit energjetike
- Vende të ndotura nga prodhimi dhe përpunimi i metaleve
- Vende të ndotura nga industria e mineraleve
- Vende të ndotura nga industria kimike
- Vende të ndotura nga menaxhimi i mbeturinave
- Vende të ndotura nga aktivitetet e minierave
- Vende të ndotura nga aktivitetet tjera.

Një klasifikim të ngjashëm për vendet e ndotura (hotspotet), varësisht nga burimi i ndotjes i gjejmë edhe në aneksin e I-rë **te Direktives së IPPC-së**.

5. Trajtimi i hotspotëve në Kosovë

5.1 Legjilacioni nacional për trajtimin e hotspotëve

Edhe pse konsiderohet se në Kosovë ka disa hotspotë, ende nuk ka ligj apo udhëzim administrativë të veçantë për rregullin e kësaj çështje.

Rregullimi i deritanishëm i problemeve të hotspotëve është trajtuar duke u bazuar në kuadër të disa ligjeve mjedisore si:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit,
- Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis,
- Ligji për Miniera dhe Minerale
- Ligji VSMS
- Ligji i Mbeturinave
- Ligji i Kemikateve
- Ligji për Biocide
- Ligji për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes
- Ligji i Natyrës

Si dhe disa Udhezime administrative.

5.2 Korniza strategjike dhe programore

Kosova ende nuk ka ndonjë strategji, plan apo program të veçant për trajtimin e hotspotëve. Trajtimi i kësaj çështje deri me tani është përfshirë në kuadër të Strategjive, Planeve dhe Programeve tjera si përmes:

- Strategjis së Kosovës për Mjedis 2005-2010
- Planit të Kosovës për Veprim në Mjedisit 2005-2010
- Draft Strategjis për Sektorin Minerar
- Planet Lokale për Veprim në Mjedis
- Draft Strategjinë për Administrimin e Mbeturinave, etj

5.3 Projektet e realizuara për rehabilitimin e hotspotëve

Sa i përket monitorimit, vlerësimit, studimit dhe trajtimit të hotspotëve deri me tani MMPH, i është qasur këtij problemi me forma të ndryshme goftë përmes projekteve studimore për gjendjen e tyre ose projekteve për rehabilitimin e tyre. Kontribut të çmueshëm në këtë çështje kanë dhënë edhe institucionet tjera qeveritare, organizatat ndërkombëtare dhe donatorët e ndryshëm.

Gjate viteve 2007-2009 një pjese e investimeve mjedisore janë orientuar në rehabilitimin e disa deponive dhe mbylljen e plotë të deponive të vjetra të mbeturinave komunale dhe atyre industriale.

Në kuadër të Planit të Kosovës për Veprim në Mjedis 2006-2010, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, gjatë vitit 2007 ka investuar në rehabilitimin e tri deponive të mbeturinave komunale në: Kaçanik, Prizren dhe Gjakovë, ndërsa gjatë vitit 2008 janë rehabilituar deponitë në: Lipjan, Prizren dhe Gjilan. Gjatë vitit (2009) Komisioni Evropian në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka investuar në rehabilitimin mbylljen edhe të tetë deponive të vjetra të mbeturinave komunale.

Të dhëna për projektet e realizuara për rehabilitimin e deponive të vjetra janë prezantuar në tabelen vijuese. Investime tjera nga MMPH-ja janë bërë edhe në ndërtimin e shtatë qendrave për sterilizimin e mbeturinave infektive spitalore, si dhe në ngritjen e impianteve për ruajtje të përkohshme të mbeturinave të rrezikshme.

Tabela 2 : Projektet për rehabilitimin e deponive të vjetra të mbeturinave komunale 2007-2009

Emri i projektit	Donatori	Viti i realizimit te projektit
Rehabilitimi i deponis së Prizrenit	MMPH	2007
Rehabilitimi i deponis së Gjakovës	MMPH	2007
Rehabilitimi i deponis së Kaçanikut	MMPH	2007
Rehabilitimi i deponis së Ferizajt	MMPH	2008
Rehabilitimi i deponis së Gjilanit	MMPH	2009
Rehabilitimi i deponis së Lipjanit	MMPH	2008

Ministria e Zhvillimit Ekonomik të Kosovës në përkrahjen edhe të organizatave ndërkombëtare dhe të donatorëve ka realizuar disa projekte për rehabilitimin e deponive industriale sikur janë: Projekti i Spastrimit dhe i Rikultivimit të Tokës nga deponia e hirit në KEK- Obiliq, trajtimi i deponive në Artanë, trajtimi i deponisë në Kelmend etj. Të dhëna për disa nga projektet e realizuara në këtë fushë janë prezantuar në tabelën vijuese.

Tabela 3: Disa projekte të realizuara nga donacionet ndërkombëtare për rehabilitimin e mjedisit

Nr.	Projekti	Donatori	Vlera në Euro
	Restaurimi i pjesherishem i Djerines ne Zhitkovc	DUTCH	109.609
	Menagjimi i mbeturinave te ngurta ne PIM	DUTCH	202.344
	Sigurimi i kemikaljeve ne PIM	DUTCH	9.535
	Sigurija e mureve per rreth rezervoareve te Ac. Sulfurik	DUTCH	32791
	Trajtimi i mbeturinave te lengeta ne PIM	DUTCH	457.021
	Riparimi i Kulmit te trafo stacionit	DUTCH	27.567
	Sigurija e rrethit – Rrethoja dhe Ndriqimi	DUTCH	24.256
	Demolimi, PIM	DUTCH	229.774
	Pastrimi i rrethit ne Zvecan – Rrethi i Shkrietoresh	DUTCH	223.582
	Vleresimi i hapsires se Djerinave , Planet e Mbylljes	DUTCH	220.229
	Stacioni për Monitorim te ajrit	S I D A	496
	Ameliorimi (Permirsimi) i rrjedhes se Prockes – Kizhnice	S I D A	3.000
	Marrja e dheut per mbulim	S I D A	20.750
	Riprofilimi Deponise Gracanica (Faza e pare	S I D A	286.330
	Menagjimi i mbeturinave të ngurta ne Zvecan	DANIDA	400.000
	Restaurimi – Permirsimi i Deponise ne Zhitkovc	Komisioni Evropian	1.000.000

6. Gjendja e Hotspoteve në Kosovë

6.1 Hotspotet e identifikuar

AMMK, në kuadër të detyrav dhe përgjegjësive që ka si institucion dhe në kuadër të aktiviteteve të saj në Planin e Punës ka bërë identifikimin e disa prej këtyre zonave. Identifikimi i hot-spoteve potenciale i realizuar nga AMMK ka gjetur mbështetje edhe nga UNDP përmes angazhimit të një eksperti ndërkombëtarë.

Gjatë këtij hulumtimi janë identifikuar disa pika të ndjeshme mjedisore, mirëpo janë evidentuar vetën ato zona të cilat kanë ndikim më të madh në mjedis dhe që paraqesin rrezik për shëndetin publik. Gjatë punës në terren në tërë territorin e Kosovës janë identifikuar rreth 110 vende si pika të ndjeshme mjedisore, ndërsa si zona me potencial për ndikim më të madh në mjedis dhe që paraqesin rrezik për shëndetin publik janë evidentuar 28 sosh dhe të cilat janë të prezantuara në këtë Raport.

Sipërfaqja e tërësishme e këtyre hotspotëve është rreth 9.94 km² ose 0.09% e territorit të Kosovës. Të dhënat e prezantuara në këtë raport janë kryesisht të natyrës informuese, dhe përveç për informimin e publikut për gjendjen e hot-spoteve mundë të shërbejnë edhe si një bazë e mirë për hartimin e projekteve për rehabilitimin e hotspotëve por edhe për orientimin e politikave dhe donacioneve në fushën e mjedisit.

Të dhënat e grumbulluara gjatë vizitës në terren për këto hot-spote për nevoja të këtij raporti dhe për një prezantim më të lehtë për tu kuptuar për publikun do të prezantohen të ndara sipas këtyre grupeve:

- Hotspote nga kemikatet
- Hotspote nga aktivitetet bujqësore
- Hotspote nga sektori i transportit
- Hotspote nga deponitë sanitare
- Hotspote nga sektori i industrisë
- Hotspotet nga sektori minerar
- Hotspote nga materiet radioaktive

6.2 Hotspotet nga kemikatet

Sipas të dhënave ekzistuese janë të njohura me shumë se 100.000 lloje të kemikateve në tregun Evropian. Vetëm një numer i vogël i tyre që gjenden në treg janë të studiuar dhe të testuara për vlerësuar se sa të sigurta janë ato dhe çfarë rreziqesh paraqesin për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

Industritë e ndryshme kimike në botë, ende vazhdojnë të prodhojnë mijëra lëndë të ndryshme kimike për çdo vit, që shumë pak janë të testuara për ndikimet e tyre në njerëz dhe mjedis qoftë për periudha të shkurtë apo afatgjate.

Keq administrimi i kimikateve, pesticideve bujqësore dhe biocideve në përgjithësi përmes avullimit të tyre ose kalimit në mjedis përmes formave tjera mundë të sjellin pasoja serioze për shëndetin e njeriut, biodiversitetin, shtresën e ozonit dhe në përbërësit tjrë të mjedisit⁴.

Mbeturinat e kemikaleve janë ndotës të sipërfaqeve të mëdha tokësore si rezultat i veprimtarive të industrisë dhe teknologjisë, shkarkimeve nga proceset e ndryshme industriale dhe akumulimit të tyre. Kemikalet toksike kanë afinitet të madhë të depërtojnë në mjedise të ndryshme si në lumenjvë dhe liqej, ajër, tokë madje edhe në detëra dhe oqeanë.

Industria kimike në Kosovë deri në vitin 1989 ka qenë dega më e rëndësishme e industrisë. Aktualisht ka shumë pak prodhime vendore të kemikateve të rrezikshme, por sasia më e madhe e tyre importohen nga vendet e ndryshme të botës.

Megjithkëtë, në disa depo, garazhe apo holle të fabrikave kanë mbetur sasi të mëdha të kemikateve të cilat kontrollohen dhe monitorohen pjesërisht e disa prej tyre fare. Ato ruhen në kushte të papërshtatshme. Në të shumtën e rasteve janë pa pronar dhe pa mbikëqyerje, me çka rritet mundësia për keqpërdorime dhe aksidente⁵. Deri me tani për reduktimin e rrezikut nga substanca të tilla kimike janë realizuar aktivitete në disa ndërmarrje, kryesisht të mbeshtetura nga donacionet dhe aktivitetet e KFOR-it dhe TMK-së (FSK-së)⁶.

Vlerësohet se këto vende, janë seriozisht të kontaminuara dhe paraqesin rrezik permanent për popullatën që jeton në afërsi të tyre. Nga kjo formë e kontaminimit të tokave nuk mbetet pa u ekspozuar edhe ujërat nëntokësore dhe sipërfaqesore dhe kështu në mënyre zingjirore mund të kërcënohet shëndeti i popullatës dhe kafshëve.

Si më problematike paraqiten sidomos industritë që aktualisht janë jashtë funksionit dhe që posedojnë mbetje të kemikaleve nga proceset e dikurshme të prodhimit. Problemi bëhet edhe më i madh kur dihet fakti se

4 Vlerësimi Mjedisore në Shqipëri pas Konfliktit, UNDP

5 Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis, 2006-2010, MMPH, Prishtinë, 2006.

6 Raporti Gjendja e Mbeturinave në Kosovë, 2008

ende nuk është i kompletuar sistemi rregullative dhe legjislativ, edukimi i përdorueseve të kemikateve si dhe informimi për rrezikshmerin e tyre.

Në Kosovë mungojnë politika dhe strategjitë specifike për përdorimin dhe administrimin e mbeturinave të rrezikshme dhe kemikaleve. Kosova nuk është përfshirë akoma në Programin Ndërkombëtar për Siguri Kimike (International Program for Chemical Safety-IFCS), përmes të cilit Kosova do të rekomandohej që të ketë politika dhe strategji të qarta për adresimin e mirëfilltë të menaxhimit të kemikaleve dhe mbeturinave të rrezikshme.

6.3 Hotspotet nga aktivitetet bujqësore (pesticidet dhe fertilizerët)

Pas Luftes së II-të Botërore popullatën rurale të Kosovës e përbenin mbi 80%. Në vitin 1991 kjo përqindje ka rënë në 63%, ndërsa vlerësohet se në vitin 2000 përqindja e populltës rurale zbriti në 60%. Rrethanat e reja ndikuan në zvogëlimin e numrit të banorëve që merren apo gjenerojnë të ardhura nga bujqësia.

Pas luftës së fundit sektori i bujqësisë ishte në gjendje të vështitë, me ferma të braktisura, me ndërmarrje publike jofunksionale dhe me infrastrukturë të dëmtuar⁷. Disa prej objekteve që mbetën të pa shkatërruara u shëndërruan në depo të mbetjeve me përbërje kimike dhe fertilizues me afate të skaduar. Këto mbetje si pesticide, herbicide, insekticide dhe fertilizues që ishin të destinuar për përdorim në bujqësi, pas skadimit të afatit të përdorimit u shëndërruan në mbetje të papërdorshme dhe të rrezikshme për mjedisin.

Gjithashtu edhe objektet ku ato ruhen dhe mjedisi përreth tyre paraqet një zonë të kontaminuar që konsiderohen si hotspot mjedisor. Situatën e rëndon edhe më shumë çështja e menaxhimit jo adekuat dhe trajtimi jo i duhur i tyre. Përkundër faktit se këto objekte janë identifikuar si pika të ndjeshme mjedisore ende mungojnë informacionet e detajura për llojin, sasinë dhe përberjen kimike të tyre.

6.3.1 Depoja e mbetjeve bujqësore në Shirok të Therandës

Objekti ku janë të deponuara mbeturinat bujqësore ka një sipërfaqe prej 0.04 ha. Infrastruktura e këtij objekti është e vjetër dhe nuk i përmbush kriteret dhe standardet për deponim dhe ruajtje të sigurt të mbetjeve nga bujqësia. Për llojet e mbeturinave dhe sasinë e tyre nuk ka informacione të plota.

Dikur objekt ishte nën menaxhimin dhe monitorimin e KFOR dhe ishte i izoluar si një vend me potencial të lartë të rrezikshmërisë.


⁷ Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis, 2006-2010, MMPH, 2006.



Objekti në Shirokë, 2009



Objekti në Shirokë, 2010



Harta 2. Depoja e mbetjeve bujqësore në Shirokë-Suharekë

6.3.2 Depoja e kemikateve industriale në Pejë

Objekti ku janë të deponuar kemikatet industriale të rrezikshëm dikur ishte prone e Fabrikës së autopjesëve në Pejë. Pas luftës kemikatet industriale janë grumbulluar nga njësitet e KFOR-it dhe janë vendosur në këtë objekt. Edhe pse KFOR-i ka informacione për për origjinën, sasinë, llojin dhe rrezikshmërinë e këtyre substancave, Komuna e Pejës dhe MMPH nuk posedojnë informacione të plota për këto substanca dhe për ndikimin e tyre në mjedis dhe shëndet publik. Aktualisht objekti monitorohet vazhdimisht nga KFOR-it dhe FSK-ja.



Objekti i deponimit të kemikateve industriale në Pejë



Në foto vërehet qindra litra të kemikateve të rrezikshme



Deponimi i kemikateve të rrezikshme industriale në Pejë



Harta 3. Depoja me kemikate industriale në Pejë

Tabela 4. Hotspotet nga kemikatet e rrezikshme në Suharekë dhe Pejë

Nr	Vendi	Aktiviteti	Sipërfaqja e përafërt	Burimet potenciale të ndotjes				
				Metale të rënda	Substanca kimike	Produkte të vajrave	Materie organike	Tjera
1	Objekti i deponimit të mbetjeve bujqësore në Shirokë të Suharekës	Depo për mbeturina të rrezikshme bujqësore	0.04 ha	-	x	-	-	-
2	Objekti i ruajtjes së kemikateve industriale në Pejë	Deponimi i kemikateve të rrezikshme industriale	0.12 ha	-	x	-	-	x

6.4 Ndikimi në mjedis nga sektori i transportit

Hyrja e mjeteve motorike të vjetruara në Kosovë, importi i vajrave dhe derivateve të kualitetit të dobët (me sasi të lart të sulfurit), deponimi i joadekuat i tyre, janë po ashtu një rrezik potencial për shendetin e njerëzve dhe mjedisin.

Sektori i transportit është një ndër sektorët që ka ndikim mjaft negativ në gjendjen e mjedisit dhe në cilesinë e përbërësve të tij (ajrin, ujin dhe tokën). Ai po ashtu ndikon edhe në fragmentimin dhe degradimin e habitateve, ndryshimin e peisazhit, destinimin e shfrytëzimit të tokës dhe trashëgimin kulturore⁸. Në nivelin global transporti konsiderohet se ka ndikim edhe në ndryshimet klimatike.

Në Kosovë, me theks të veçantë janë problematike deponit e mbeturinave të veturave të përdorura si dhe deponitë vajrave dhe karburantev që nuk i plotësojnë kushtet e deponimit dhe ruajtjes. Lokacione me destinime të tilla në Kosovë janë me qindra të vendosura në vend të ndryshëm pa kriteret dhe pa leje mjedisore.



Kontaminimi me derivate- Hekurudha Fushë Kosovë

8 Plani i Kosoves për Veprim në Mjedis, 2006-2010, MMPH, Prishtine, 2006


6.5 Hotspotet nga Deponitë sanitare

Kosova ka trashëguar deponi të mbeturinave komunale në shumë lokacione. Shumica e tyre janë shpërndarë pa kritere dhe pa vlerësime paraprake. Disa prej tyre përkundër që janë të mbyllur ende nuk janë të rehabilituara. Lokacione të tilla të janë evidentuar si hotspotet potenciale dhe me ndikim në mjedis. Më problematike janë deponitë regjionale të cilat janë ndërtuar pas lufte nga donatorët e ndryshëm. Këto deponi për shkak të keq menaxhimit janë shëndërruar në rrezik potencial dhe me ndikim në ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës.

Numri i deponive komunale dhe regjionale të evidentuara si hotspotet potenciale në territorin e Kosovës konsiderohen 6 sosh, të lokalizuara në Prizren, Podujevë, Obiliq, Mitrovicë, Gjilan dhe Pejë.

6.5.1 Deponia sanitare në Podujevë

Kjo deponi është e lokalizuar në komunën e Podujevës. Madhësia e deponisë është 8.72 ha. Kohëzgjatja e përdorimit të kësaj deponie është 15 vjet. Kapaciteti total është 925 000 m³, ndërsa kapaciteti mujor 2000 T. Në këtë deponi nuk vihen në funksion pompat për riqarkullimin e ujërave të deponisë edhe pse janë në gjendje të rregullt. Ujërat e zeza nga kjo deponi derdhen në rrjedhat e afërta sipërfaqësore dhe bëjnë kontaminin e tyre. Kjo paraqet rrezik permanent për jetën e qytetarëve në afërsi të kësaj deponie.



Pamje nga deponia

Laguna e deponisë



Përzierja e ujërave sipërfaqësore me ato të deponis



Harta.4.Deponia sanitare e mbeturinave në Podujevë

6.5.2 Deponia sanitare në Pejë

Kjo deponi ka sipërfaqe prej 4.85 ha. Edhe pse e ndërtuar sipas standardeve gjendja aktuale dhe menaxhimi i kesaj deponie eshte jo e mirë. Ne këtë deponi bëhet përzierja e ujërave sipërfaqësore më rrjedhën që del nga deponia. Prania e metaleve të rënda, kemikateve dhe produkteve të vajrave në këtë deponi, bëjnë që ky lokacion të jetë burim potencial i ndotjes. Mos funksionimi i pompave të lagunës dhe mos mbulimi i mbeturinave bëjnë që gjendja në këtë deponi të shkoj drejt përkeqësimit edhe më të madh.



Pamje nga deponia sanitare në Pejë



Rrjedhja e ujit të kontaminuar nga mbeturinat e deponisë sanitare në Pejë, Mars 2012



Harta 5. Deponia sanitare e mbeturina në Pejë

6.5.3 Deponia sanitare në Gjilan

Ne këtë deponi grumbullohen mbeturinat nga Komuna e Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Novobërdës, Kaçanikut, Shtimjes dhe Ferizajt. Madhësia e deponisë është 20.50 ha dhe kohëzgjatja e përdorimit të saj vlerësohet deri në 15 vite. Kapaciteti total është 1.222 222 m³, ndërsa kapaciteti mujor 4000 t.⁹

Deponia Regjionale e mbeturinave në këtë komunë edhe pse është ndërtuar me standarde, nga keq menaxhimi ajo tani është shëndëruar në një ndotës të madh për mjedisin në këtë lokalitet. Sistemi i pompimit nuk funksionon rregullisht dhe si pasojë e bëhet përzjerje e ujërave sipërfaqesore me ato të deponisë.

Venbanimet në pjesen lindore të deponisë që janë shumë afër saj nuk shfrytëzojnë uejrat sipërfaqësore dhe nëntokësore si rezultat i kontaminimit të tyre. Gjithashtu kundërmimi që vjen nga deponia e ka bërë të pa durueshme jetën normale të kësaj popullate.

9 Raport-Gjendja e Mbeturinave në Kosovë, 2008



Ujërat e akumuluar në deponin sanitare në Gjilan



Vendbanimet afër deponisë së Gjilanit




Kontaminimi i burimit të ujit nga deponia



Burim uji i kontaminuar



Rrjedha e ujit të kontaminuar nga deponia



Harta 6 . Deponia sanitare e mbeturinave në Gjilan

6.5.4 Deponia në Prizren

Deponia ka 14 ha dhe gjendet në fshatin Landovicë të Prizrenit. Është e ndërtuar në vitin 2004 me ndihmën e fondeve nga Bashkimi Evropian. Si pasojë e keq manixhimit në këtë deponi nuk funksionon sistemi i pompimit. Gjithashtu llaguna ku bëhet grumbullimi i ujërave të deponise është hapur nga erozioni dhe paraqet rrezik për daljen e rrejdhes nga kontrolli duke rrezikuar ndotjen e ujërave nëntokesore dhe banorët që jetojnë në afërsi të kësaj deponie. Këto ujëra janë të ndoutra me kemikate të ndryshme që vijën nga substancat e ndryshme që deponohen në këtë deponi. Ujërat e patrajtuara vazhdimisht rrjedhin nga lagunat dhe përzihen me ujëra sipërfaqësore. Një problem tjetër është edhe mos mbulimi i mbeturinave.



Ujëra të akumuluar në deponin sanitare



Rrjedhja e ujërave të ndotura




Çarja e kaskadës së ujërave akumuluese të deponisë



Rrjedhja e ujërave të ndotura nga ujërat e akumuluar



Rrjedhja e ujërave të zeza nga ujërat e akumulura në deponi



Harta 7. Deponia sanitare e mbeturinave në Prizren

6.5.5 Deponia sanitare në Mirash

Deponia e mbeturinave për regjionin e Prishtinës ndodhet në Mirash të Komunës së Obiliqit. Në këtë deponi grumbullohen mbeturinat nga komunat: Prishtinë, Obiliq, Lipjan, Fushë Kosovë dhe Glllogovc. Madhësia e kësaj deponie është 33.65 ha. Kohëzgjatja e deponisë është 15 vjet. Kapaciteti total është 3.500 000 m³, ndërsa kapaciteti mujor 6 000 T.

Deponia është e vendosur në një hapësirë ku është eksploatuar ligniti për nevoja energjetike. Ky substrat është jo stabil dhe procesi i vetëndezjes së qymyrit bënë që ky lokacion të jetë i papërshtatshëm për deponim të mbeturinave urbane. Gjendja aktuale e deponisë është mjaft e rëndë si pasojë e lokacionit jo adekuat dhe keq menaxhimit të deponisë. Po ashtu pompat për trajtimin e rrjedhës së llagunës nuk futen në përdorim që nga vitit 2007. Kjo ka bërë që të zhduket tërësisht laguna për trajtimin e ujërave të deponisë. Si pasojë e kësaj vjen deri te përzjerja e rrjedhjes së deponisë

me ujërat sipërfaqësore. Një dukuri shqetësuese në këtë deponi është edhe djegia e mbeturinave që ndikon edhe në ndotjen e ajrit në këtë lokalitet.


Nga kjo deponi vjen një kundërmim i rëndë dhe me parakushte për përhapjen e sëmundjeve dhe epidemive të ndryshme.



Pamje nga deponia sanitare e mbeturinave në Mirash



Djegia e mbeturinave në deponinë e Mirashit, 2011



Harta 8. Deponia sanitare e mbeturinave në Mirash, Obiliq

6.5.6 Deponia sanitare në Mitrovicë

Në këtë deponi grumbullohen mbeturinat nga komuna e Mitrovicës, Vushtrisë, Zubin Potokut dhe Skenderajt. Sipërfaqja e deponisë është 7 ha. Kapaciteti i dizajnuar për 250 000 banorë. Kohëzgjatja për 15 vjet. Kapaciteti total është 2.000 000 m³, kurse kapaciteti mujor 2 400 T. Kjo deponi gjendet afër fshatit Gërmovë të komunës së Mitrovicës. Deponia është ndërtuar me ndihmën e organizatës qeveritare DANIDA. Gjendja në këtë deponi është e rënde, si rezultat i keqmanaxhimit që ka sjellur edhe perzierjen e ujerave sipërfaqesore me ato të deponisë. Ujërat e kontaminuara të cilat rrjedhin vazhdimisht jashtë deponisë paraqesin rrezik potencial për shëndetin publik të banorëve të këtij lokaliteti dhe për mjedisin.



Deponia sanitare e mbeturinave urbane në Komunën e Mitrovicës



Deponia sanitare e mbeturinave urbane në Komunën e Mitrovicës

Tabela 5. Deponitë sanitare si burime potenciale të ndotjes në Kosovë

Nr	Lokacioni Vendi	Aktiviteti	Sipërfaqja	Burimet potenciale të ndotjes				
				Metale të rënda	Substanca kimike	Produkte të vajrave	Materie organike	Tjera
1	Deponia sanitare në Podujevë	Deponi për mbeturina urbane	8.72 ha	x	x	x	x	x
2	Deponia sanitare në Sferk të Thatë-Pejë	Deponi për mbeturina urbane	4.85 ha	x	x	x	x	x
3	Deponia sanitare në Gjilane	Deponi për mbeturina urbane	20.50 ha	x	x	x	x	x
4	Deponia sanitare në Prizren	Deponi për mbeturina urbane	20.94 ha	x	x	x	x	x
5	Deponia sanitare në Obiliq	Deponi për mbeturina urbane	33.65 ha	x	x	x	x	x
6	Deponia sanitare në Mitrovicë	Deponi për mbeturina urbane	3.60 ha	x	x	x	x	x

6.6 Hotspotete nga aktivitetet minerare dhe industriale

Kosova ka pasur potencial të madhë industrial me destinime të ndryshme. Si pasojë sot janë trashëguar një numër i madh problemesh mjedisore, të akumuluar me dekada nga shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve natyrore dhe minerare dhe prodhimi industrial i shoqëruar me shkallë të lartë të ndotjes.

Pas vitit 1999 shumica e industrive prodhuese ishin jashtë funksionit. Shumica e këtyre industrive kishin në dispozicion mbeturina të rrezikshme, teknologji të vjetruar, objekte të demoluara dhe depo të pa menaxhuara. Të gjitha këto ndikuan në rritjen e ndikimit në mjedis. Lokacione të tilla me potencial ndotës nga industria mundë të konsiderohen si pika te nxehta (hot spote) dhe me ndikim në mjedisin. Këto lokacione janë burim i ndotjes së tokës, ujit dhe ajrit. Hapësira të gjera të tokës të kontaminuara me ujëra acidike dhe me metale të rënda e posaqërisht me Plumb, Zink, Kadmium, Arsen, Mërkur etj.

AMMK gjatë vitit 2010 ka bërë një hulumtim në territorin e Kosovës dhe ka evidentuar disa objekte të ish industrive dhe deponive të tyre që aktualisht paraqesin rrezik permanent për mjedisin dhe shëndetin publik në Kosovë. Ndër komunat më të prekura nga këto hotspotet janë: Gllogovci, Mitrovica, Suhareka, Zveçani, Graçanica, Novo Bërdo, Obiliqi, Lipjani, Gjakova, Stantërgu dhe Leposaviqi.

Disa prej këtyre industrive janë të privatizuar dhe pronarët e rinjë kanë bërë një rehabilitim të pjeshëm të mjedisit përreth tyre.

6.6.1 Hotspotet nga sektori i industrisë

Në mesin e industrive me potencial të lartë prodhues dikur ishte Ballkani i Suharekes. Sikur shumica e industrive tjera edhe kjo industri ka trashëguar lloje të ndryshme të mbeturinave të rrezikshme si vajra të përdorura, shirita gome, kemikale dhe mbeturina tjera, të cilat kanë kontaminuar hapësirën e objektit. Lokacioni kishte të deponuara mbeturina të rrezikshme dhe deri në vitin 2009 ishte shëndërruar në një deponi industriale (shiko foto).



Mbeturinat e vajrave të përdorura në ndërmarrjen Ballkani në Suharekë, 2009

Edhe sot në këtë lokacion, përkundër faktit se janë ndërmarrë masa për largimin e mbeturinave të rrezikshme nga ambientet e jashtme, një sasi e tyre ende mbetet e deponuara në depot e ndërmarrjes. Po ashtu ende nuk janë marrë masa për rehabilitimin e dheut të kontaminuar nga vajrat dhe materiet tjera.

Ndotjes së mjedisit në këtë lokacion i ka kontribuar edhe djegia e vajrave të deponuara gjatë procesit të prodhimit. Kjo e ka ngritur nivelin e ndotjes për mjedisin çka është një faktor kërcënues për shëndetin e punonjëseve dhe të popullatës për rreth.





Mbetjet e vajrave të përdorura nga procesi teknologjik

Pas privatizimit të ndërmarrjes, menaxhmenti i ri ka marrë masa për përmirsimin e gjendjes së mjedisit në këtë lokacion duke eliminuar mbeturinat e reciklueshme si dhe duke investuar edhe në sektorë tjerë me qëllim të përmirësimit të gjendjes.




Ballkan Suharekë, Mbeturinat të ndryshme të përziera, Mars 2011



Ballkan Suhareke, Korrik 2011

Edhe pse nga fotot shihet se mbeturinat e vajrave në oborrin e ndërmarrjes pothuaj se janë eliminuar, problemi ka mbetur ende për shkak se toka është e kontaminuar nga vajrat e përdorura me vite të tera. Edhe pse menaxhmenti i ndërmarrjes ka hartuar një plan për rehabilitimin e hapësirës përreth fabrikës, ende nuk është realizuar ndonjë projekt konkret për të pastruar tokën e kontaminuar.



Harta 9. Fabrika e Ballkanit të Suharekës

Tabela 6. Fabrika për prodhimin e gomave dhe shiritave, Ballkani i Suharekës

Nr	Vendi	Aktiviteti	Sipërfaqja	Burimet potenciale të ndotjes				
				Metale të rënda	Substanca kimike	Produkte të vajrave	Materie organike	Tjera
1	Fabrika e Ballkanit të Suharekës	Mbetjet nga vajrat dhe shiritat e gomës	17.17 ha	-	x	x	-	-

6.6.1.1 Parku ndustrial në Mitrovicë


Parkun Industrial në Mitrovicë e përbëjnë ish Industria e Baterive, Metalurgjia e Zinkut dhe Industria Kimike. Në kuadër të aktiteteve punuese metalurgjike respektivisht kimike të këtyre industrive krahas finalizimit të lëndëve të para ato kanë krijuar edhe mbeturina të rrezikshme për mjedisin. Këto mbeturina janë hedhur në afërsi të këtij parku me ç'rast janë krijuar deponitë e këtyre mbeturinave, të cilat janë në një hapësirë të përbashkët. Kjo deponi shtrihet në anën perëndimore të PIM-it dhe nga njëra anë kufizohet me lumin Sitnicë. Deponia e mbetjeve industriale ka sipërfaqe prej 34,62 hektar. Masa e tërësishme e këtyre mbetjeve industriale llogaritet të jetë rreth 1 520 000 tonelata. Deponia përbëhet prej katër llojeve të mbetjeve industriale, piritit dhe pirotinës, fosfogjipsit, jarositit dhe të ashtuquajturës mbetje prej procesit të finjzimit neutral të fërgesës së zinkut e njohur edhe si fundërrinë EMKO. Lokacioni në të cilën gjindet kjo deponi rritet shqetësim për ndikimin e saj në mjedis, për faktin se kjo hapësira përreth është zonë me vendbanime dhe afër lumit.



Deponitë industriale në Parkun Industrial, Mitrovicë



Kafshët duke u ushqyer në zonën e PIM



Harta 10. Parku industrial i Trepçës në Mitrovicë

6.6.1.2 Deponia e skories së Feronikelit në Çikatovë-Gllogovc


Kompleksi i industrisë së Feronikelit daton që nga viti 1984 dhe ka funksionuar deri në vitin 1998. Kompleksi Feronikeli tani është në pronësi private të dy magnateve izraelite dhe llogariten si njëra ndër ndërmarrjet më të mëdha në Kosovë. Kjo industri e rëndë bënë prodhimin e hekurit dhe të nikelit.

Mbetjet nga prodhimi industrial i Feronikelit hudhen në një hapësirë afër lumit Drenica duke krijuar kodra të skories. Deponia ka sipërfaqe rreth 24 ha kurse zona e ndikimit 45 ha dhe llogaritet si burim potencial i ndotjes. Përveç mbeturinave të Nikelit – këtu akoma hidhen edhe mbeturiant komunale të Gllogocit.

Mesatarisht nga prodhimi gjenerohen 1 milion ton m^3 skorie në vit. Në përbërjen e vetë kimike skoria ka SiO_2 , MgO , FeO dhe CaO .



Deponitë e skories industriale në Çikatovë të Re, Gllogovc



Harta 11. Deponia e skories industriale të Feronikelit, Glogoc

Tabela 7. Deponia industriale me mbetjet e skorjes në Çikatovë të Re, Gllgovc

Nr	Vendi	Aktiviteti	Sipërfaqja	Burimet potenciale të ndotjes				
				Metale të rënda	Substanca kimike	Produkte të vajrave	Materie organike	Tjera
1	Çikatovë e re, Komuna e Gllgovcit	Mbeturinat e skorjes së Feronikelit	24 ha Zona e ndikimit 71.37 ha	x	-	-	-	-

6.6.2 Hotspotet nga sektori minerar

Në kuadër të deponive nga sektori minerar janë evidentuar si hotspote potenciale deponitë në Hajvali, Badovc, Kishnicë, Miniera e Artanës me Deponitë e saj, Miniera e Stan Tërgut, Deponitë në Kelmend, materiet në Parkun Industrial të Trepçës në Mitrovicë, Deponitë në Zveçan, Deponitë në Lepasaviq, Deponitë e hirit në KEK, Deponitë e flotacionit në Devë të Gjakovës, Miniera e Goleshit në Magurë të Lipjanit dhe Deponitë e azbestit në Han të Elezit.

6.6.2.1 Deponitë në Hajvali, Badovc dhe Kishnicë

Kjo trevë është e pasur me resurse natyrore të rëndësishme për zhvillimin ekonomik.

Miniera e Badovci është njëra ndër vendburimet më të rëndësishme të Plumbit dhe Zinkut të fushës xeherore Hajvali, Badovc dhe Kishnicë. Ajo gjendet në juglindje të Prishtinës përkatësisht në pjesën më veriore të fushës xeherore. Fusha xeherore gjendet në lindje të pellgut neogjen të Kosovës në mes shkallëve 21°29" të gjatësisë gjeografike lindore dhe 42°21" të gjerësisë veriore sipas Grinuiçit.

Edhe lokacioni i minieres së Kishnicës dhe potenciali industrial i saj, paraqet një hapësirë me potencial ndotës dhe mundë të konsiderohet si hot spot mjedisor. Eksploatimin në këtë fushë shoqërohet edhe me pasurimin e xehes në flotacionin i cili gjendet aty. Ky lokacion është i ndotur edhe nga deponitë e shumta minerare, të shpërndara në mënyrë të parregullt dhe pa ndonjë kriter për të parandaluar dëmet në mjedis.

Eksploatimi i xehes në këtë lokacion është bërë deri në vitet e 90-ta, mirëpo aktiviteti i flotacionit nuk është ndërprerë pasi që aty është bërë pasurimi i xehes së eksploatuar nga vendburimi i Artanës.

Kompleksi i minierave përfshinë sipërfaqe rreth 100 ha. Në këtë kompleks si lokacione më të ndjeshme mjedisore janë evidentuar:

- Deponia e Minierës së Badovcit, (afër pendës së Liqenit të Badovcit), në të cilën ka koncentrim të metaleve të rënda si: Plumb dhe Zink. Deponia ka sipërfaqe rreth 1 ha;
- Deponia e materialit steril, mbetjeve të minierës së Kishnicës me koncentrim të Plumbit dhe Zinkut. Kjo deponi ka sipërfaqe rreth 5 ha ;



Penda e Liqenit të Badovcit



Deponia e Minieres afër pendës së Liqenit të Badovcit



Harta 12. Deponitë e minierës të Kishnicës në Badovc




Deponia e materialit steril në Kishnicë



Deponia e materialit steril në Kishnicë



Harta 13. Deponia e minierës në Kishnicë



Deponia e rehabilituar në Kishnicë

Tabela 8. Deponitë me mbetje të metaleve të rënda të minierës së Kishnicës, Graçanicë

Nr	Vendi	Aktiviteti	Sipërfaqja	Burimet potenciale të ndotjes				
				Metale të rënda	Substanca kimike	Produkte të vajrave	Materie organike	Tjera
1	Deponia e minierës afër pendës së Liqenit të Badovcit Kishnicë, Graçanicë	Përmbajtja e Pb, Zn, Ari	2.85 ha	x	-	-	-	-
2	Deponia e materialit steril, mbetjeve të minierës së Kishnicës, Graçanicë	Përmbajtja e Pb, Zn, Ari	10.23 ha	x	-	-	-	-
3	Deponia me metale të rënda, Graçanicë (e rehabilituar)	Përmbajtja e Pb, Zn, Ari	70 ha	x	-	-	-	-

6.6.2.2 Miniera e Artanës


Fusha xeherore e Artanës shtrihet në zonën malore të Rodopeve, në lindje të Kosovës dhe njihet si zona malore e Artanës dhe e Gollakut. Kjo zonë shtrihet në skajin lindor të Rrafshit të Kosovës dhe shtrihet në mes të lumit Llap në veri, lumit Morava e Binçit në jug dhe Fushës së Kosovës në perëndim. Fusha xeherore e Artanës mbulon pjesën më të madhe të fshatit Marec. Administrativisht sipërfaqja e kësaj fushe i takon komunave Gjilan, Kamenicë, Prishtinë dhe Artanë.

Ish qyteti i vjetër i Artanës shtrihet në pjesën veri-lindore të Kosovës, rreth 25 km në vijë ajrore, gjegjësisht 40 km në vijë tokësore në lindje të Prishtinës dhe rreth 30 km në veri të qytetit të Gjilanit.

Zona malore e Artanës dhe Gollakut gjegjësisht fusha xeherore e Artanës dallohet me relief më lartësi prej 800-1335m mbi nivelin e detit. Ky relief është shprehje e një evolucioni paleogjeografik, gjeologjik dhe tektonik.

Lumenjtë më të njohur më rrjedhje të përhershme janë lumi i Marecit, lumi i Bostanit dhe lumi i Vitisë. I gjithë ky teritor karakterizohet edhe me burime natyrale të ujit të cilat në të shumtën e rasteve dalin në vendet e punimeve të vjetra dhe të galerive të cilat janë hapur në të kaluarën dhe tani janë të mbuluara.

Si rezultat i eksploatimit të xeheve nga Miniera e Artanës janë krijuar dy deponi të mbeturinave buzë lumit Krivareka (Lumi i lakuar). Këto dy janë hotspotet tipike mjedisore. Ato paraqesin burim potencial të ndotjes sidomos me plumb, zink dhe sulfur.



Ujërat acidike të minierës së Artanës¹⁰

10 Foto UNDP Kosovo



Rehabilitimi i deponive në minierën e Artanës¹¹

Lokacionet në të cilën gjenden dy deponit e minieres janë:

- Deponia Mareci 1, që ka koncentrim të lartë të plumbit dhe zinkut, me sipërfaqe prej 2 ha. Llogaritet se kjo deponi ka përafërsisht një sasi të mbetjeve prej 350.000 t;
- Deponia Mareci 2 e cila gjithashtu ka ndotje me metale të rënda si Zink dhe Plumb dhe ka sipërfaqe rreth 4 ha. Kjo deponi llogaritet të ketë përafërisht rreth 2000.000 ton mbetje.

Përbërja e deponive është heterogjene dhe përmbajtja e metaleve të rënda është: Pb=1-1.56%, Zn=1.76-3.22%, Ag=20-110gr/t, Au=2-2.59gr/t, Fes²=60-70%¹²

Deponitë gjenden buzë lumit Marec. Janë të ndërtuara jashtë rregullave tekniko-minerare dhe shkaktojnë ndotje jo vetëm në lokacionin ku ndodhen por edhe më gjerë. Ato nuk kanë penda të qëndrueshme dhe janë të ekspozuara erozionit të vazhdueshëm. Gjendja e tyre vazhdon të jetë e rëndë edhe pas projektit për rehabilitimin e tyre, projekt ky i financuar nga UNDP.



Deponia e minierës së Artanës, Mareci 1

11 Foto UNDP Kosova

12 Sipas të dhenave nga menaxhmenti i minieres me flotacion, Artanë-Kishnicë



Deponia e minierës së Artanës -Mareci 1



Bagëtitë kullosin afër deponisë së minierës së Artanes- Mareci 1

Deponia e Marecit 1, pos problemeve të shumta teknike të krijuara gjatë procesit të rehabilitimit, edhe sot është problem në vete për arsye se sipërfaqja e deponisë është e mbuluar nga shtresa e dheut e cila vazhdimisht i ekspozohet erozionit dhe brenda një kohe jo të largët mund të kthehet në gjendjen e mëparshme.



Deponia e minierës së Artanës, Mareci 2




Ujrat acidike që rrjedhin nga miniera e Artanës, Deponia Mareci 2

Edhe Deponia e Marecit 2, ishte rehabilituar nga një projekt i UNDP. Përkundër investimit të bërë deponia e rehabilituar nuk i përmbush standartet. Gjendja aktuale e deponisë dhe argjinaturave të saj nuk është e mirë dhe nuk ka masa mbrojtëse për mbrojtjen e lumit dhe mjedisit përrëth nga ndotja.

Tabela 9. Deponitë e minierës në Artanë

Nr	Vendi	Aktiviteti	Sipërfaqja	Burimet potenciale të ndotjes				
				Metale të rënda	Substanca kimike	Produkte të vajrave	Materie organike	Tjera
1	Mareci 1 dhe 2	Deponi e Plumbit dhe Zinkut	2.38 ha	x	-	-	-	-



Harta 14. Deponitë e minierës në Artanë

6.6.2.3 Miniera e Stan Tërgut

Miniera e Stan Tërgut ndodhet rreth 8 km në verilindje të Mitrovicës. Konsiderohet një nga minierat më të pasura me Plumb, Zink dhe Argjend në Evropë. Që nga viti 2000 janë duke u bërë përpjekje për rehabilitimin dhe funksionimin e saj me ndihmën dhe përkrahjen e institucioneve të Kosovës dhe disa donatorëve.

Problemi më i madhë mjedisore nga kjo minerë është uji i ndotur i minierës i cili është duke u ndotur hapësirën për rreth minierës si pasojë e rrjedhjes në tokë dhe depërtimit në ujërat nëntokësore. Një problem tjetër është pluhuri që vjen nga deponitë e pa mbuluara të kësaj miniere.

Në këte zonë si hotspotet mjedisore konsiderohen deponia e mbetjeve industriale Leposaviq –Bostanishte, Deponia e mbetjeve industriale Zveçan-Zhitkovc, Deponia e mbetjeve industriale Zveçan/Mitrovicë/Gornje Pole, Deponia e mbetjeve industriale te Tuneli i Parë, Deponia e mbetjeve in-

dustriale Badovc-Potok, Deponia e mbetjeve industriale (Depozitimi i hirit) Zveçan, Deponia e mbetjeve industriale Mitrovicë dhe Impianti i mbetjeve nga shkrija e mineraleve në Zveçan.


6.6.2.4 Deponia në Kelmend

Rajoni ku ndodhet deponia i takon fushës xeherore të Trepçës. Është i përbër nga shkëmbinjët magmatik dhe shkëmbinjëve sedimentar të metamorfizuar të palezoikut të ri dhe triasikut, ultramafitet, formacionit vullkanogjeno-sedimentar të jurasikut të sipërm, produkteve të serisë së oligocenit të sipërm, krijimeve liqenore të miocenit të pliocenit dhe krijimeve kuaternare. Deponia shtrihet mbi një zonë e cila ka përbërje gjeologjike prej brekqieve vullkanike-kuarclatite, andeziteve dhe tufeve të neogjenit; formacioneve silikor-diabaz të jurasikut si dhe rreshpeve gëlqeror të triasikut.

Gjatë periudhës së ndërtimit të deponisë, janë bërë disa shpime të cilat nuk e kanë vërtetuar prezencën e ujërave nëntokësore në këtë zonë. Pranë deponisë nuk kalon asnjë lum me rrjedhje të përhershme gjatë tërë vitit kështu që në deponi derdhen vetëm ujërat atmosferik dhe ujërat që vijëjnë nga flotacioni së bashku me mbetjet nga flotimi i xehe në Tunelin e parë. Ky ujë krijon një liqe dhe më pastaj pas trajtimit fizik përmes kolektorëve derdhet në lumin Ibër. Ujërat e dala nga nëntoka e minierës me rrjedhje rreth 300 m³/h shkarkohen te flotacioni në Tunel të parë në prrockën Trepça, si dhe një pjesë e tyre së bashku me ato që lirohen nga procesi i flotimit barten deri në deponi.

Deponia e materialit të mbetur pas procesit të flotimit, zë një sipërfaqe prej afro 18 ha. Këtu deponohet materiali që vie nga miniera dhe flotacioni. Edhe pse deri me tani janë bërë disa punime për trajtimin e kësaj deponie, ajo mbetet rrezik i madh si për banorët ashtu edhe për mjedisin rrethues.

Një problem i veçantë që ndëlidhet me këtë deponi është edhe fakti se gjatë kohës me erëra të forta bëhet bartja e grimcave të pluhurit në një hapësirë më të gjerë duke shkaktuar kështu ndotjen e ajrit, ujërave dhe tokës përreth.



Harta 15. Topografia e deponis së Kelmendit në Mitrovicë ¹³



Penda e deponisë në Kelmend

13 Elaborat o izversenom ugradjivanju pijezometra na glavnoj brani jalovista flotacije rudnika „Trepca”-Stari Terg na Zarkovom Potoku (Kelmend) -1983



Liqeni akumulues në deponinë e Kelmendit



Tabelë paralajmëruese për rrezikun nga deponia

6.6.2.5 Materiet radioaktive te Tuneli i parë- Mitrovicë

Në Trepçë përkatësisht në Tunelin e Parë ndodhen tri fuqi me materie radioaktive të sjellura nga KFOR-i Francez. Materiet radioaktive janë: ameri-cium një fuqi, stroncium dhe thorium një fuqi. Po ashtu këtu ndodhet edhe një materie tjetër në formë kripe por nga raportit i KFOR-it nuk ka të dhëna se për çfarë lloji të materies bëhet fjalë. Këto materie radioaktive janë të vendosura në depo të veçantë dhe janë nën mbikëqyrjen e KFOR-it. Në bazë të raportit mbi matjen e radioaktivitetit të këtyre materieve, të bëra nga Brigada Shumëkombëshe Veri-Lindje të datës 26 mars 2005, N° 02/BMN-Ne/Em/G32D/NBCRT, vetëm ameri-ciumi tejkalon dozën e lejuar prej $2,5 \mu\text{Gy}/h$.



Depoja ku janë të vendosura materiet radioaktive



Materiet radioaktive të Americiumit, Stronciumit dhe Thoriumit

6.6.2.6 Materiet radioaktive në Parkun Industrial në Trepçë, Mitrovicë

Në laboratorit qendror të Metalurgjisë së Zinkut janë të deponuara 12 boca me peshë afër 1.2 kg të Nitratit të Thoriumit. Shkalla e rrezatimit të tyre është rreth $9 \mu\text{Gy}/h$, ndërsa sipas standardeve shkalla e lejuar është $2.5 \mu\text{Gy}/h$. Substanca gjindet në një kasoafortë të metalit dhe është e shenjzuar me shenjën e rrezikut nga radioaktiviteti. Substanca monitorihet nga KFOR-i francez. Prejardhja e tyre nuk dihet.



Objekti i laboratorit



Materiet radioaktive te deponuar ne Laborator-PIM

6.6.2.7 Deponitë në Zveçan

Kjo deponi është krijuar si pasojë e procesimit të xehes së Plumbit dhe Zinkut në Flotacionin e vjetër në Zveçan. Ndryshe është e njohur edhe si deponija e sterilit në Gornje Pole. Ajo ndodhet afër Shkriitorës së Plubit në Zveçan dhe fare pranë saj ndodhet edhe rrjedha e lumit Ibër. Deponia ka sipërfaqe rreth 50 ha kurse sasia e sterilit të deponuar llogaritet të jetë rreth 12 milion t¹⁴.

Përveç kësaj deponije edhe në Zhitkovc, 2 km nga Zvecani, gjendet edhe një Deponi tjetër e sterilit të Flotacionit të vjetër të Zvecanit, me sipërfaqe rreth 26 ha dhe me sasi të sterilit rreth 12 milion ton. Përbërja kimike e sterilit në Zhitkovc është e ngjashme me sterilin e Zveçanit. Kjo është rehabilituar me ndihmën e Komisionit Evropian me një donacion rreth 1 milion Euro.

Në shkrioren e Plumbit në Zveçan, gjatë shkrierjes redukuese të aglomeratit të Plumbit në furrat e larta, ka mbetur zgjyra e Plumbit. Kjo mbetje është vendosur gjithashtu në Deponin e sterilit në Zveçan. Sasia e zgjyrës në Deponinë e Zveçanit, llogaritet të jetë rreth 2,6 milion t dhe zë një sipërfaqe rreth 5 ha.



Deponitë e Zveçanit


14 Vlerësim nga AER, 2002

6.6.2.8 Deponitë në Leposaviq

Afër flotacionit në Leposaviq ndodhen dy deponi. Njëra është aktive dhe tjetra është e mbyllur. Në deponinë aktive ka rreth 3.7 milion ton mbetje nga flotacioni kurse në atë të mbyllur llogaritet të ketë rreth 2.7 milion ton mbetje.



Foto: Deponitë në Leposaviq




Harta 16. Deponia e flotacionit në Leposaviq


Tabela 10. Përbërja kimike e deponive me metale të rënda në pjesën veriore të Kosovës¹⁵

Lokacioni	Gornje Polje	Zhitkovc	Leposaviq	Leposaviq	Zveçan
Gjendja aktuale	Mbyllur	Mbyllur	Mbyllur	Aktive	Mbyllur
Tipi	Deponi e sterilit	Deponi e sterilit	Mbetje flotacioni	Mbetje flotacioni	Deponi e sterilit të granular
Sasia në ton	12	9	2,7	3,7	2,6
Përbërja kimike e mbetjeve					
Al₂O₃ %	1,6		2,8		0,02
Bi mg/kg	17		<10		25
Cd mg/kg	<10		18		
Cu %	0,013		0,012		
Fe₂O₃ %	32		24		29
MgO %	<1		3,9		
Ni %	0,023		0,079		
Pb %	0,21		0,33		2,0
Zn %	0,14		0,26		
ZnO %					7-12
Ag g/t	12				256
SiO₂ %					18-20
CaO %					20-22

15 Vlerësim nga AER, 2002



Harta 17. Materiet radioaktive te Tuneli i parë, laboratorit në PIM dhe deponia sanitare në Germovë-Mitrovicë



Harta 18. Deponitë minerare në Zveçan dhe Kelmend

Tabela 11. Deponitë industriale me metale të rënda dhe materiet radioaktive të deponuara në Mitrovicë

Nr	Vendi	Aktiviteti	Sipërfaqja	Burimet potenciale të ndotjes				
				Metale të rënda	Substanca kimike	Produkte të vajrave	Materie organike	Tjera
1	PIM	Mbetje te metaleve te rënda nga metalurgjia e zinkut, procesi i jarositit, impianti per plehra artificial, bateri, elektrolizë e zinkut, djegia e piritit dhe mbetjet e fosfo-gipsit	115.10 ha	+	+	-	-	+
2	PIM	Deponim me materie radioaktive të Nitrat Toriumit	0.04 ha	-	-	-	-	+
3	Tuneli i Parë	Deponim të materieve radioaktive: Stroncium, Torium dhe Americium	0.03 ha	-	-	-	-	+
4	Deponi industriale në Zveçan	Deponi e metaleve të rënda	62.28 ha	x	-	-	-	-
5	Deponi industriale në Leposaviq	Deponi e metaleve të rënda	20.31 ha	x	-	-	-	-

6.6.2.9 Deponitë e hirit në KEK

Deponitë e hirit të Termocentralit Kosova A ndodhen në afërsi të fshatit Mirash të komunës së Obiliqit. Ato kanë sipërfaqe rreth 110 ha. Përveç mbetjeve të hirit nga procesi i prodhimit të energjisë në këtë Termocentral në këtë deponi hudhet edhe zgjyra nga mbetjet e thëngjillit. Përveç sasisë së madhe të hirit të deponuar ky lokacion paraqet rrezik permanent edhe për shkak të jostabilitetit të hirit të deponuar i cili manifestohet me rrëshqitje të herë pas hershme. Edhe shpërndarja e hirit nga era paraqet një problem tjetër që është karakteristikë e këtij hotpoti.



TEC A dhe kodrinat e mbetjeve të hirit

Hiri i grumbulluar në deponi krijohet gjatë procesit të djegjes së linjtit dhe gjenerimit të energjisë elektrike. Transportimi i hirit nga TC A në deponitë ekzistuese bëhet përmes shiritave të hapur transportues. Nga TC B, transportimi i hirit bëhet përmes sistemit hidraulik me gypa dhe deponohet në hapësirat e minierës së eksploatuara të Mirashit. Deponimi i hapur i hirit në TCA ka si pasojë shpërndarjen e pluhurit në ajër si dhe ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësor në këtë zonë.

Tabela 12: Përmbajtja e hirit të deponive të KEK-ut sipas komponentëve përbërëse¹⁶

Analizat e hirit	%
SiO ₂	38
Al ₂ O ₃	6.8
Fe ₂ O ₃	5.4
CaO	35
MgO	18
SO ₃	8.3

¹⁶ Raporti, Gjendja e Mbeturinave në Kosovë, AMMK 2009



Deponimi i Hirit nga TEC A



Deponitë e hirit nga TEC A, ndotja e ajrit nga pluhuri



Vendbanimi afër deponis së TEC A në Mirash

Tabela 13: Deponitë e hirit nga procesi industrial energjetik te KEK-ut¹⁷


Emri i deponis	Sipërfaqja	Sasia vjetor	Vëllimi	Pesha në mil.ton
Deponitë e TC A	181.97 ha	0,87 mil.m ³ /vit	25 mil.m ³	34 mil.t
Deponite e TC B	192.92 ha	0,93 mil.m ³ /vit	14 mil.m ³	20 mil.t.

Lokacione tjera me potencial të ndotjes në zonë KEK-ut janë edhe Impianti i parë i TC-A dhe TC-B. Në këto impiante ka koncentrik të lartë të metaleve të rënda, substancave kimike dhe vajrave të përdorura.

¹⁷ Shërbimet e KEK-ut, Departamenti i mjedisit-Raporti 2009

Tabela 14. Deponit e hirit dhe rezervaret me fenole ne KEK

Nr	Vendi	Aktivititet	Sipërfaqja	Burimet potenciale te ndotjes				
				Metale të rënda	Substanca kimike	Produkte të vajrave	Materie organike	Tjera
1	Deponia e hirit nga termo-centrali Kosova A	Deponia e hirit	181.97 ha	-	x	x	-	x
2	Termocentrali Kosova B	Deponia e hirit dhe Termocentrali Kosova B	192.94 ha	-	x	x	-	x
3	Rezervuaret me fenole, TEC A dhe areali i ndikimit	Rezervuaret me fenole dhe ndikimi	177.64 ha	-	x	x	-	x



Harta 19. Deponia e TEC- B, rezervuaret me fenole dhe deponia e TEC- A

6.6.2.10 Deponitë e flotacionit në Devë të Gjakovës

Xeheroret e kromit gjinden në pjesën qendrore të masivit të Gjakovës në territorin e vendburimit të Deves. Horizontet ku gjenden xehet e kromit janë të shpeshta por që vendburimet janë me sipërfaqë të vogla. Paraqitjet më interesante ndodhën në pjesën lindore të masivit, në zonën perëndimore në mes të fshatrave Petkoviq dhe Labuçevë. Përbërja kimike e xehes së kromit sillet prej: Cr_2O_3 - 35-55%, Al_2O_3 -8-23% dhe FeO rreth 13%¹⁸. Nxjerrja dhe pasurimi i xehes në fabrikën e pasurimit në Devë ka krijuar edhe deponitë e tyre. Kjo deponi ka sipërfaqe prej 1 ha. Vlerësohet se kjo deponi paraqet burim potencial të ndotjes me metale të rënda dhe paraqet kërcënim për mjedisin dhe rrjedhat ujore në këtë zonë.



Deponitë nga flotacioni i Devës, Gjakovë



Deponia kryesore e flotacionit në Devë të Gjakovës

18 Elaborat o Istražnim Radovima na Djakovičkom Serpentinitskom Masivu u Toku 1969 Godine – ICMM Reg.-No. 0004/A



Harta 20. Deponia e flotacionit në Devë, Gjakovë

Tabela 15. Deponia e flotacionit të minierës në Devë, Gjakovë

Nr	Vendi	Aktiviteti	Sipërfaqja.	Burimet potenciale të ndotjes				
				Metale të rënda	Substanca kimike	Produkte të vajrave	Materie organike	Tjera
1	Flotacioni i minierës së Kromit në Devë	Deponia e meta- leve të rënda	5.23 ha	x	-	-	-	-

6.6.2.11 Miniera e Goleshit në Magurë- Lipjan


Në Golesh dhe Strezovc ndodhen dy miniera të magnezitit ($MgCO_3$). Te dyja këto miniera kanë nisur së eksploatuari si kariera dhe ka vazhduar eksploatimi dhe shfrytëzimi i tyre deri në mbyllje në vitin 1999. Sipas disa vlerësimeve në vitin 1990, në Golesh prodhohej rreth 110 000 ton magnezit, 22 000 ton magnezium dhe 10000 ton magneziumi kaustik të kalçinuar për vit. Miniera e Goleshit është shfrytëzuar me një pus minerar, ndërsa miniera në Strezovc me anë të nje galerie¹⁹.

Kjo minierë ka një sipërfaqe prej 15.13 ha dhe paraqet burim potencial të ndotjes me metale të rënda, magnez dhe me mbetje të vajrave të përdorura.





Ambientet e Minerës në Golesh



Harta 21: Industria e minierës së Goleshit në Magurë

Tabela 16. Mbetjet nga miniera e Goleshit në Magure

Nr	Vendi	Aktiviteti	Sipërfaqja	Burimet potenciale te ndotjes				
				Metale të rënda	Substanca kimike	Produkte të vajrave	Materie organike	Tjera
1	Miniera në Golesh, Komuna e Lipjanit	Minierë e magnezit dhe metaleve të rënda	15.13 ha	X	-	x	-	-

6.6.2.12 Deponia me materie të asbestit në Han të Elezit

Si rezultat i prodhimtarisë së Fabrikës së Cimentos SharrCem dhe Fabrikës për prodhimin e Salonitit në Han të Elezit janë krijuar dy deponi me mbetje të asbestit. Një sasi e konsiderueshme e mbetjeve të asbestit është deponuar në dy anët e lumit me një sipërfaqe prej 0.50 ha. Vetëm në pjesën e majtë të rrjedhës së lumit janë të deponuar mbetje azbesti që zënë një sipërfaqe rreth 0.18 ha. Ky lokacion gjindet prapa Fabrikës së Cimentos SharrCem dhe Fabrikës për prodhimin e Salonitit, pranë urës së lumit Lepenc.

Një lokacion tjetër i deponimit të mbetjeve të asbestit është edhe ai ndërmjet stadiumit të qyteti dhe lumit Lepenc dhe ka një sipërfaqe prej 0.42 ha. Pos mbetjeve të asbestit në këtë deponi jana të hedhura edhe mbeturina të ndërtimit dhe mbeturina komunale.

Mbetjet e asbestit në këto lokacione janë hedhur pas vitit 1999 dhe prezenca e tyre paraqet rrezik për mjedisin rrethues dhe në veçanti për ekosistemin e lumit Lepenc.

Nuk është bërë ende ndonjë studim për të identifikuar llojin e saktë të mbetjeve të asbestit, por vlerësohet se këto mbetje mundë të jenë disa lloje si ato të llojit fibër apo të llojit pluhur sikurse janë: Krokidolit ose Asbest i Kaltër, Aktinolit, Antofilit, Krizotil ose Asbest i Bardhë, Amozit apo Asbest i Hirt dhe Tremolit.

Për përmirësimin e situatës dhe zvogëlimin e rrezikut nevojitet që të behet trajtimi i këtyre mbetjeve, ose deponimi i tyre në një vend të veçantë.



Fabrika e SharrCem



Rrjedhja e ujit të ndotur nga SharrCemi



Fabrika për prodhim të Salonitit



Deponia e mbetjeve të Asbestit afër urës së Lumit Lepenc



Deponia me mbetje të Asbestit dhe me mbeturina tjera afër stadiumit të qytetit



Harta 22. Deponitë me mbetje të Asbestit në Han të Elezit

7. Të dhëna të përmbledhura për hotspotet

Në tabelën vijuese janë prezantuar disa të dhëna të përmbledhura për të gjitha hotspotet potenciale të identifikuar. Nga të dhënat e prezantuara vërehet se shumica e hotspotëve potencial janë nga veprimtaritë industriale dhe minerare disa prej të cilave janë aktive edhe sot e disa të tjera nuk janë aktive por kanë në pronësi materie të rrezikshme ose zona të kontaminuara.

Tabela 17 : Hot-spotet mjedisore sipas lokacioneve, aktivitetit, sipërfaqes dhe burimeve potenciale të ndotjes

Nr.	Lokacioni	Aktiviteti në të kaluarën	Sipërfaqja	Burimet potenciale të ndotjes				
				Metale të rënda	Kemik-alie	Vajra	Materie organike	Tjetër
1.	Objekti i ish Ndërmarrjes së Agro-Kulturave në Shirokë-Komuna e Therandës	Depo për mbeturina të pesticideve dhe fertilizues	0.04 ha	-	+	-	-	-
2.	Objekti i ish Fabrikës së automjeteve në Pejë	Depo për kemikale të rrezikshme industriale	0.12 ha	-	+	+	-	-
3.	Deponia Sanitare komunale në Podujeve	Deponi e mbeturinave	8.72 ha	-	+	+	+	+
4.	Deponia Sanitare komunale në Pejë	Deponia e mbeturinave	4.85 ha	-	+	+	+	+
5.	Deponia sanitare regjionale në Gjilan	Deponi e mbeturinave	20.50 ha	-	+	+	+	+
6.	Deponia sanitare regjionale në Prizren	Deponi e mbeturinave	20.94 ha	-	+	+	+	+
7.	Deponia sanitare regjionale në Mirash-Obiliq	Deponi e mbeturinave	33.65 ha	-	+	+	+	+
8.	Deponia sanitare komunale në Mitrovicë	Deponi e mbeturinave	3.60 ha	-	+	+	+	+

9.	Fabrika për prodhim të gomave dhe trakave-Suharekë	Mbetje të vajrave dhe kontaminim i tokës	17.17 ha	-	+	+	-	-
11.	Parku Industrial Mitrovicë	Deponit industriale	115.10 ha	+	+	-	-	-
12.	Deponia Industriale e Feronikelit-Çikatovë-Drenas	Deponia e Skories industriale te Feronikelit	24 ha sip, zona e ndikimit 71.37 ha	+	-	-	-	-
13.	Deponia e Minierës afër pendës, Badovc	Deponia me metale të rënda	2.85 ha	+	-	-	-	-
14.	Deponia e materialit steril në Kishnicë	Deponia me metale të rënda	10.23 ha	+	-	-	-	-
15.	Deponia e Mareci 1 dhe Deponia Mareci 2, Proji i djaloshit, Miniera Artanë	Deponia me metale te rënda	2.38 ha	+	-	-	-	-
16.	Deponia në Kelmend-Mitrovicë	Deponia me metale te rënda	23.78 ha	+	-	-	-	-
17.	Materiet radioaktive në kombinatin industriale në Trepçe Mitrovice	Objekti-Deponim me metale radioaktive, Nitrat Toriumi	0.04 ha	-	-	-	-	+
18.	Materiet radioaktive te Tuneli i Parë, Mitrovicë	Objekti-Deponim me metale radioaktive, Stronciumi, Torium dhe Americium	0.03 ha	-	-	-	-	+
19.	Deponitë industriale në Zveçan	Deponi të metaleve të rënda	62.28 ha	+	-	-	-	-
20.	Deponit industriale në Leposaviq	Deponi te metaleve te rënda	20.31 ha	+	-	-	-	-
21.	Deponia e hirit në TEC A	Deponitë industriale termoenergjetike	181.97 ha	+	+	+	-	+
22.	Deponia e Hirit në TEC B	Deponit industriale termoenergjetike dhe areali i ndikimit	192.94 ha	+	+	+	-	+
23.	Rezervuaret me fenole	Rezervuare me fenole	177.64 ha	+	x	x	-	x
24.	Deponia e Minierës në Devë-Gjakovë	Deponi me metale të rënda	5.23 ha	+	-	-	-	-
25.	Miniera në Golesh-Komuna e Lipjanit	Eksplotimi dhe përpunimi i metaleve të rënda	15.13 ha	+	-	+	-	-
26.	Hani i Elezit, Kompleksi industrial SharCem	Dy deponi të me materie të asbestit	0.60 ha	+	+	-	-	+


Në tabelën 17 janë të prezantuara hot spotet potenciale sipas aktivitetit nga i cili janë krijuar. Nga tabela vëreht se pjesa më e madhe e këtyre hotspot

teve janë nga aktivitetet minerare të përfaqësuara me deponi minerale (26.6%), deponi të hirit (30.1 %) dhe deponi industriale (27%). Në total të gjitha hotspotet e Kosovës zënë një sipërfaqë prej 0.09 % të sipërfaqës së Kosovës.

Tabela 18. Tabela e përgjithshme e hotspoteve me aktivitetet, sipërfaqen dhe përqindjen

Nr.	Aktiviteti	Sipërfaqja në km ²	Përqindja nga totali i hotspoteve	Sipërfaqja e mbuluar në nivel Kosove në km ²
1	Deponi minerale	2.66	26.6	0.024
2	Deponia e Hirit	3.01	30.1	0.027
3	Deponia industriale	2.7	27.08	0.024
4	Deponia e mbeturinave	0.93	9.3	0.008
5	Materie radioaktive	0.67	6.7	0.006
	Total	9.97	100	0.091

Sa i përket shpërndarjes hapësinore të hotspoteve potenciale, numri më i madh i tyre ndodhet në pjesëm qendrore dhe në pjesën veriore të Kosovës.



Harta 23. Lokacionet e hotspoteve në Kosovë

8. Efektet e hotspotëve në shëndet dhe mjedis

Mjedisi ka rëndësi shumë të madhe për mirëqenien fizike, mendore dhe sociale të njeriut. Marrëdhëniet komplekse mes faktorëve të mjedisit dhe shëndetit të njeriut, duke marrë në konsideratë ndërveprimet e shumta, duhet të shihen në një kontest më të gjerë hapësinor, socio-ekonomik dhe kulturorë. Degradimi i mjedisit, nëpërmjet ndotjes së ajrit, zhurmës, kimikateve, cilësisë së ujit dhe humbjes së zonave natyrore dhe i kombinuar me ndryshimet në mënyrën jetesës mundë të ndikojnë në masë të madhe në cilësinë e shëndetit të njeriut²⁰

Ekspozimi ndaj kemikateve shoqërohet me rënie të funksionit të organeve gjenitale, mal-formime gjenitale, probleme të zhvillimit mendor, obezitet dhe sëmundje kancerogjene. Po ashtu edhe mbetjet e paisjeve elektrike dhe elektronike, që përmbajnë metale të rënda, komponime perzistente dhe bioakumuluese, kemikate dhe materie të tjera të përdorura në plastike, tekstil, kozmetikë, pesticide dhe paketime të janë shqetësime që ndikonjë në shëndetin e njeriut. Edhe kemikatet që përdoren për zjarëfikje si Brominatet, Ftalatet, Bisfenoli A dhe kemikatet e Perfluorinuara kanë efekte negative në shëndetin e popullatës.

Në sistemin e shpejtë alarmues të BE-së, për produktet e rrezikshme jo-ushqimore, (i cili vepron që nga viti 2004), rreziqet kimike janë të përfaqësuar me 26% të totalit të njoftimeve në bazë të një hulumtimi të vitit 2009. Në Bashkimin Evropian ekziston rregullorja për regjistrim, vlerësim, autorizim dhe kufizim të kemikateve (REACH), që ka për qëllim të përmirësoj mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga rreziqet e kemikateve.

Kur flitet për pesticidet dhe fertilizer tjerë mundë të themi se ato i prishin proceset bilologjike në mjedis. Përzierja e pesticideve janë të zakonshme si në furnizimin me ushqime të njeriut, në mjediset ujore dhe në toke ku efektet zakonisht kanë ndikim në hormonet e transmetimeve nervore apo të mimikës. Andaj Strategjia e BE-se, për Përdorim të Qëndrueshëm të Pesticideve vendos objektiva për të minimizuar dëmet dhe rreziqet për shëndetin dhe mjedisin që vijnë nga pesticidet si dhe për të përmirësuar kontrollin mbi përdorimin dhe shpërndarjen e tyre. Zbatimi i plotë i Direktives së Pesticideve është i nevojshëm për të mbështetur arritjen e statusit të mirë kimik sipas Direktives Kornizë të Ujit.

20 Mjedisi i Evropës, gjendja dhe perspektiva 2010, sintezë

Politikat evropiane mjedisore kanë për qëllim të ofrojnë një mjedis në të cilën niveli i ndotjes nuk sjell efekte të dëmshme në shëndetin e njeriut. Në kuadër të këtyre përpjekjeve janë edhe Programi i 6 –të i Veprimit në Mjedis (EAP-6), Strategjia e BE-së për Mjedis dhe Shëndet, Plani i Veprimit 2004-2010, dhe procesi Pan-Evropian i OBSH-së për Mjedisin dhe Shëndetin.

Hotspotet që gjinden në mjedis të ndryshëm reflektojnë me ndikime direkte në shëndetin dhe mjedisin rrethues. Hulumtimet dhe studimet e deritanishme në këtë lëmi deri me tani në Kosovë janë të pakta. Janë kryer disa hulumtime dhe studime nga UNDP-ja, OBSH-ja, Ministria e Zhvillimit Ekonomik si dhe nga Universiteti i Prishtinës etj.

Hulumtimet dhe studimet janë bërë kryesisht në regjionin e Mitrovicës i cili njihet për praninë e lartë të plumbit në gjak të popullatës së këtij regjioni, për shkak të mbetjeve industriale metalurgjike nga Industria e rëndë e trashëguar ndër vite.

Një nga hulumtimet që është bërë në popullatën e kampeve strehimore në Mitrovicë është ai i OBSH-së. Kampet janë të vendosura vetëm rreth 3 km largë nga vendi ku është bërë shkrirja e plumbit të Trepçes dhe rreth 500 m larg mbetjeve të minierës.

Sipas këtij hulumtimi është vlerësuar se gjendja shëndetsore e popullatës së kampeve është mjaft e rëndë nga efekti i plumbit në gjakë. E kjo vërehet sidomos tek fëmijët dhe gratë shtatëzëna. Studimi për efektet në shëndet nga ky kontaminim që rrjedhë nga deponitë industriale të Trepçes është realizuar në 186 persona gjatë periudhës dhjetor 1999 deri në korrik 2007.

Ndikimi i këtij kontaminimi në shëndetin e popullatës në këtë rajon ka rezultuar me paraqitjen e sëmundjeve kronike, sëmundjeve të sistemit të qarkullimit të gjakut, efekte anësore të fëmijët sikur janë demtimi i mëlçisë, veshkave, trurit, rritje jo normale, ndikim tek shtatëzënat, vonesa në zhvillim të fëmijeve, paraqitje të sjelljeve jo-normale, impulse të dobëta reagimi, humbje dëgjimi etj.

Duhet të veçohet se niveli i lartë i plumbit në gjak (>75 mg/dl), mund të shkaktojë madje edhe konvulsione, gjendje kome dhe vdekje. Efektet negative janë evidentuar posaçërisht te moshat e reja dhe fëmijët²¹.

Një tjetër studim i realizuar në të njëjtin regjion është kryer nga Dekonta, a.s. një kompani Çeke për shërbime konsultuese për vlerësim dhe riparim të mjedisit. Sipas rezultateve të hulumtimit, popullsia e Mitrovicës kishte dukshëm nivele më të larta të plumbit në gjakë se sa regjionet tjera

21 The European Journal of Public Health Advance Access published November 6, 2009, European Journal of Public Health, 1–5, The Author 2009. Published by Oxford University Press on behalf of the European Public Health Association.

të Kosovës. Për shembull, popullata e Mitrovicës ka përqëndrim më të lart të plumbit në gjakë për disa herë se sa ajo e Prishtinës.

Studimi thotë se tek 12 % e femijëve që jetojnë në Mitrovicë niveli i plumbit në gjak ka tejkaluar 70 µg / dL ndërsa 35% e fëmijëve kanë rezultuar me përqëndrim 50-69 µg / dL. Gjithashtu është vlerësuar se rreth 9 000 fëmijë në Mitrovicë mund të kenë koncentrim të plumbit në gjak mbi 40 µg / dL.

Niveli i përqendrimit të plumbit në gjak është hasur për tri herë më i lartë se gratë shtatëzëna në regjionin e Mitrovicës se sa tek gratë shtatëzëna të regjionit të Prishtinës. Për këtë shkak Parku Industrial në Mitrovicë është një ndër pikat më të nxehta mjedisore jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë²².

22 Final report – draft, PS 2009-07, DEKONTA, a.s. joint- stock company Consulting services for Environmental Assessment and Remedial nga Republika e Çekisë, October, 2009

9. Konkluzionet dhe rekomandimet

Në bazë të rezultateve dhe të dhënave të prezantuara në këtë raport mundë të konkludohet se:

- Në Kosovë janë evidentuar si 28 hotspote potenciale mjedisore,
- Disa prej tyre sikur janë deponitë sanitare me një menaxhim më të mirë nuk do të ishin burime dhe vende potenciale të ndotjes,
- Pjesa më e madhe e hotspoteve janë nga sektori industrial dhe minierave dhe janë të kontaminuara me metale të rënda,
- Ka pasur një numër të vogël të projekteve në rehabilitimin e hotspoteve e veçanërisht në deponitë me metale të rënda,
- Është një numër i vogël i hulumtimeve për ndikimet e hotspoteve në shëndetin e popullatës me përjashtime të disa hulumtimeve në regionin e Mitrovicës të realizuara nga institucionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare,
- Popullata ka njohurit të pakta për hotspotet mjedisore dhe rrezikun që vjen prej tyre,
- Është bërë pak në vetëdijësimin e popullatës në lidhje me rrezikun që sjellin hotspotet mjedisore,
- Nuk ka strategji të veçantë për trajtimin e hotspoteve mjedisore në Kosovë,
- Nuk ka programe rehabilituese për hotspotet mjedisore,
- Është investuar shumë pak në rehabilitimin e hotspoteve mjedisore krahasuar me nevojën dhe numrin e madhë të tyre për rehabilitim,
- Nuk ka bashkëpunim të mirë të institucioneve për koordinim e veprimeve për zgjidhjen e problemit të hotspoteve mjedisore,

Si rrjedhojë e kësaj gjendje rekomandohet që të merren këto masa:

- Të bëhet analiza e gjendjes së hotspoteve dhe të realizohen studimi të veçanta për secilin hot spot të propozuar në këtë raport,
- Të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis nga secili hotspot mjedisor,
- Të hartohen programe të veçanta të monitorimit të ujrave sipërfaqësor, nëntokësore dhe tokës nga hotspotet mjedisore,
- Të rishikohet sistemi aktual i menaxhimit të deponive urbane, industriale dhe minerare,
- Të hartohen Plane dhe Strategji për rehabilitimin e hotspoteve mjedisore

- Të krijohen fonde për rehabilitimin e hotspotëve mjedisore
- Të rritet bashkëpunimi në mes institucioneve qendrore dhe lokale me qëllim të kordinimit të aktiviteteve për reduktimin e hotspotëve mjedisore,
- Komunat duhet të iniciojë hartimin e Planeve Lokale për hotspotëve me qëllim të caktojnë prioritetet e menaxhimit më efikas të tyre dhe hartimit të projekteve për rehabilitimin e tyre.
- Ti kushtohet vëmendje e veçantë procesit të privatizimit të ndërmarrjeve që kanë trashëguar hotspotë mjedisore dhe të kërkohet nga pronarët e rinj që të investojnë në rehabilitimin e tyre,
- Të fillohet me implementimin e ligjit të IPPC-së
- Të hartohen politika më efikase dhe më të qendrueshme për eliminimin e hotspotëve mjedisore.

Për zgjidhjen e problemit të hotspotëve në të ardhmen duhet të ndërmerren edhe këto masa:

Sektori industrial dhe minerar

- Sektori i industrisë dhe sektori minerar duhet të marrë masa për integrimin dhe zbatimin e sistemit të administrimit të mjedisit dhe teknologjive më të pastëra (BAT), për të parandaluar ndotjen (reduktimin e substancave toksike, mbeturinave, përdorimin me eficient të energjisë dhe minimizimin e shpenzimeve.
- Menaxhimin dhe ruajtjen në vende adekuate të mbeturinave të rrezikshme (kemikaleve dhe metaleve të rënda),
- Sigurimin e nje fondi mjedisor, subvencioneve apo granteve te ndryshem për menaxhimin më të mirë të mbeturinave të rrezikshme industriale,
- Menaxhmenti në sektorin e industrisë dhe atë minerar duhet të bejë më shumë në përmirësimin e kushteve të mjedisit (aplikimin e riciklimit, zvogëlimin e substancave ndotëse, përcaktimin e zonave të rrezikshme etj.)
- Të themelohet një qendër emergjente për avari apo dëme mjedisore që mundë të vijnë nga sektori i industrisë dhe ai minerar,
- Informatat mjedisore brenda ketyre dy sektoreve do të duhej të menaxhohen në mënyrë më efikase dhe të jenë transparentë për publikun,
- Për të dy sektorët nevojitet të zbatohen politika më të mira për një zhvillim të qendrueshëm mjedisorë në përputhje me legjislacionin mjedisor nacional dhe me Direktivat e BE-së..

Sektori i mbeturinave

- Menaxhimi aktual i Deponitve sanitare nuk është i mirë andaj kërkohet zbatimi i sistemeve më efikase për menaxhimin, trajtimin, рецикlimin, ripërdorimin dhe deponimin e tyre.
- Duhet të bëhen përpjekje maksimale të parandalimit të mbeturinave dhe reduktimit të tyre,
- Të ketë mirëmbajtje të vazhdueshme teknike të deponive sanitare me qëllim që të mos lejohet përzierja e ujërave sipërfaqesore me ato të deponisë.
- Te zbatohet Plani strategjik për administrimin e mbeturinave dhe masat e planifikuara për deponitë.

Sektori i bujqësisë

- Deponimi dhe sigurimi i mbetjeve bujqëore (pesticide, fertilizerë et) të behen në vende të përshtatëshme për ruajtjen e tyre për shkakë të rrezikshmeris së madhe që kanë për mjedisin
- Të ketë menaxhim më efikas të produkteve kimike që përdoren në bujqësi dhe përdorimi më eficient i tyre,
- Të bëhet vetëdijësimi i farmerëve, bizneseve dhe konsumatorëve për përdorimin e materieve të rrezikshme në sektorin e bujqësisë.

Sektori i transportit

- Stimulimi i shfrytëzimit të automjeteve të reja në transport dhe ndalimi i përdorimit të automjeteve të vjetra,
- Përdorimi i karburanteve me kualitet të lartë dhe me ndikim më të vogël në mjedis. Karburantet me përqendrim më të ulët të sulfurit (më pak se 0.001%).
- Respektimi i legjisllacionit për limitet e shkarkimeve të emisionëve ndotëse në ajër nga transporti dhe i akteve ligjore për cilësinë e karburanteve,
- Menaxhimi më efikas i mbetjeve nga transporti (të riciklohen apo të ruhen në vende që i plotësojnë standardet për deponim)

10. Referencat

- Raporti statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike në Kosovë T4 – 2009, faqe 9;
- Vlersimi Mjedisore në Shqipëri pas konfliktit, UNDP;
- Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis, 2006-2010, MMPH, Prishtinë, 2006;
- Raport- Gjendja e mbeturinave në Kosovë, 2008;
- Elaborat o izversenom ugradjivanju pijezometra na glavnoj brani jalovista flotacije rudnika „Trepca“-Stari terg na Zarkovom Potoku (Kelmend) -1983,
- Të dhëna nga menaxhmenti i minierës me flotacion-Artanë-Kishnicë;
- Të dhëna nga menaxhmenti i Trepçës;
- Vlerësime nga AER -2002;
- Shërbimet e KEK-ut, Departamenti i mjedisit-Raporti 2009;
- www.kosovo-mining.org;
- Mjedisi i Evropes, Gjendja dhe Perspektiva 2010, Sintezë;
- The European Journal of Public Health Advance Access published November 6, 2009, European Journal of Public Health, 1–5, The Author 2009. Published by Oxford University Press on behalf of the European Public Health Association.
- Final report – draft, PS 2009-07, DEKONTA, a.s. joint- stock company Consulting services for Environmental Assessment and Remedial nga Republika e Çekisë, October, 2009.

Adresa e AMMK-së:
Rruga Luan Haradinaj, ish-pallati i shtypit-Rilindja kati XV/04
Tel. +381 38 200 33 228 ,
email: kepa@rks-gov.net
www.ammk-rks.net

Prishtinë, Shtator 2012

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

504.61:62(047)

Hotspotet mjedisore në Kosovë : raport / përgatitur nga
Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. - Prishtinë : Minis-
tria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor : Agjencia për Mbro-
jtjen e Mjedisit të Kosovës , 2012. - 98 f. : ilustr. me ngjyra ; 21 cm.

Parathënie : f. 11.- Referencat : f. 97

ISBN 978-9951-638-00-5